

Dr. Musli Vërbani

RREGULLA TË FIKHUT

Kaçanik, 2020

Titulli:

Rregulla të fikhut

Autor:

Dr. Musli Vërbani

Lekturoi:

Burim Bunjaku

Të drejtën e ribotimit e rezervon autori

Definicioni i rregullave fikhore

Secila shkencë i ka rregullat, bazat dhe kriteret e saj, po kështu edhe shkenca e rregullave fikhore i ka bazat dhe kriteret e saj.

Në etimologji **kaidetun** e ka kuptimin e bazës, themelit dhe shtyllës.

Fjala **shtyllë** vjen në kuptim konkret dhe në kuptim abstrakt.

Në kuptim konkret **kaidetun** i thuhet *shtyllës së shtëpisë*.

Në kuptim abstrakt **kaidetun** i thuhet shtyllava si f.v. *shtyllat e fesë*.

Në etimologji fjala **fikh** do të thotë kuptim.

Në terminologji **fikh** do të thotë: Njohja e ligjeve praktike të Sheriatit përmes argumenteve të veçanta.

Në terminologji **Kaide fikhijje (rregull fikhore)** domethënë: Ligj i përgjithshëm, prej të cilit nxirren nënligje të shumta prej atij ligji të rregullit fikhorë.

Historiku i rregullave Fikhore

Rregullat fikhore kanë filluar me fillimin e ligjësimit të sheriatit.

Kur'ani ka zbritur, dhe në vete ngërthente shumë prej rregullave fikhore, te cilat rregulla i ka shpjeguar Muhamedi a.s.

Tabiinët janë munduar që të i përfitojnë rregullat fikhore nga Kur'ani dhe suneti dhe nga thëniet e sehabeve.

Ndoshta prej librave të parë është libri “El-Haraxh” i Ebu Jusufit, në të cilin libër hasen shumë rregulla fikhore.

Medhhebi Hanefi konsiderohet prej medhhebeve të para e cila është marrë me këtë lëmi, pastaj kjo lëmi ka vazhduar të zhvillohet në mënyrë graduale deri në ditët e sotme.

Rëndësia e rregullave të Fikhut

Në njohjen e rregullave fikhore ka shumë dobi, por më e rëndësishmja prej tyre është përvetësimi i çështjeve të ngjashme në lëmin e fikhut.

Rregullat e Fikhut i ndihmojnë ekspertit të fikhut për të kuptuar programin e fetvave dhe pasqyrimin e argumenteve të fikhut.

Rregullat e Fikhut i ndihmojnë dijetarit t'i kuptojë ligjet dhe argumentet të cilat nuk janë precizuar nga dijetarët e mëhershëm.

Rregullat e Fikhut ia mundësojnë ekspertit të fikhut të i mësojë çështjet sekondare të fikhut dhe shumicën e çështjeve tjera që kanë të bëjnë me ligjet.

KAPITULLI I PARË

Ndërlidhmënia e qëllimeve me të nënkuptuarit e fjalës dhe të substancës së saj.

Vlefshmëria e veprave dhe pranimi i tyre varet nga pastërtia e zemrës dhe çiltërsia e nijetit.

Nijeti ka dy kuptime:

Kuptimi i parë: Singëriteti ndaj Allahut me fjalë dhe me vepër. Ky është kuptimi i përgjithshëm; dhe

Kuptimi i dytë: Përputhshmëria e qëllimit me veprën, dhe ky është kuptim specifik.

Në këtë kapitull i kemi parapa 3 rregulla e ato janë:

1. Çështjet gjykohen sipas qëllimeve.
2. Qëllimi dhe nijeti llogariten në veprime dhe deklarime ashtu siç llogariten në shpërblime dhe adhurime.
3. Në akte llogaritet qëllimi dhe kuptimi, ndërsa nuk llogaritet fjala dhe konstrukti i fjalës.

EL UMUURË BI MEKAASIDIHAA

1. Çështjet gjykohen sipas qëllimeve.

Fjala **mekasid** është shumësi i fjalës **meksad** dhe **kasd** që d.m.th. **qëllim** a **synim**.

Në etimologji, fjala **meksad** ose **kasd**, nënkupton **nijetin**, **dëshirën** dhe **vullnetin** për të bërë diçka.

Në terminologji, **mekasid** nënkupton *gjërat që të shtyjnë për të bërë një vepër*.

Kuptimi i rregullës

Veprat e njeriut që është i ngarkuar me detyra fetare varen nga nijeti i tij.

Veprat e tij janë të vlefshme në qoftë se nijeti i tij është i vlefshëm.

Veprat e tij janë të pavlefshme poqëse nijeti i tij është i prishur, i pavlefshëm.

Ky rregull është prej rregullave më të rëndësishme të fikhut.

Ky rregull i dallon veprat e plota të cilat pranohen nga veprat tjera të cilat nuk pranohen.

Argument

Argument për këtë e kemi thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

“E ata nuk ishin të urdhëruar me asgjë tjetër, pos që ta adhuronin Allahun me adhurim të sinqertë ndaj Tij.” (El- Bejine : 5)

Argument tjetër e kemi thënien e Muhamedit a.s.:

“Qëllimi (nijeti) i besimtarit është më i vlefshëm se sa veprat e tij.”

Në një rast tjetër, Muhamedi a.s. ka thënë:

“Veprës i paraprinë qëllimi (nijeti).”

- nëse një person ka për qëllim kënaqësinë e Allahut, atëherë shpërblehet për atë qëllim, ndërsa,

- nëse ai ka për qëllim kënaqësinë e njeriut, atëherë shpërblehet për atë qëllim.

Për çështjen e hixhretit, Muhamedi a.s. ka thënë: **“Veprat çmohen sipas qëllimit dhe se çdokujt i takon ajo që e ka për qëllim:**

- kush shpërngulet (bën hixhret) për Allahun dhe për të dërguarin e Tij, shpërngulja (hixhreti) e tij është për Allahun dhe për të dërguarin e Tij,

- kush shpërngulet për të mira të kësaj bote, ose për t’u martuar me ndonjë femër, ai do të marrë vetëm çka ka synuar.”

Edhe pse hadithi ka të bëjë për një rast të veçantë, synimi është i përgjithshëm dhe nuk ka të bëjë vetëm me rastin e hixhretit.

Nijeti (qëllimi) është ligjësuar për të dalluar adhurimet prej traditave dhe për ta dalluar një adhurim prej një adhurimi tjetër.

Ky rregull aplikohet në çështje të:

- adhurimeve (ibadat), dhe

- veprimtarisë njerëzore (muamelat).

Nijeti në çështje të adhurimeve (ibadat)

Mund të ndodhë që një person pikësynon kryerjen e një obligimi por i ndodh që nuk mund ta kryej atë, atëherë për atë obligim vlerësohet pozitivisht.

Nijeti në çështje të veprimtarisë ndërnjerëzore (muamelat)

Nijeti i cili nuk shprehet për një çështje dhe ajo çështje nuk veprohet, nga ky nijet nuk rezulton efekt ligjor i sheriatit.

Shembull:

- Nëse një person e shkurorëzon gruan me nijet, pra me zemër, por nuk e shpreh me gjuhë, ai shkurorëzim nuk prodhon efekt në ligje të sheriatit sepse ligjet e sheriatit bazohen në aspekt të jashtëm dhe jo të brendshëm.

- Nëse një person e blen një send me qëllim që ta lë vakëf, dhe pasi që e blen nuk e shpreh me diçka që e dëshmon se është duke e lënë vakëf, atëherë ai send nuk mund të ligjësohet si vakëf.

Shprehja e qartë dëshmon vërtetësinë dhe pas shprehjes së qartë nëse personi dëshiron të arsyetohet me nijet, nuk merret parasysh nijeti.

Nëse një person thotë, ia dhuroj filanit këtë send, më vonë nuk i pranohet arsyetimi se ai është mahitur dhe nuk e ka pasur seriozisht, pra nuk merret parasysh nijeti, por merret parasysh shprehja e tij.

- Në qoftë se ndokush i jep ndonjë të varfri njëqind euro për hir të Allahut, atëherë kjo sadaka (lëmoshë) është e vlefshme.

- Nëse ia jep ato për ta lavdëruar njerëzit, konsiderohet vepër e bërë për sy e faqe, rrjedhimisht është e refuzuar.

- Poqëse ia jep pa ndonjë qëllim: as për hir të Allahut e as për ta parë njerëzit, atëherë kjo është një vepër për të cilën nuk ka fare shpërblim.

- Nëse një person i jep dikujt pasuri duke pasur për qëllim lëmoshën yullnetare, e më pas të njëjtën dëshiron ta shndërrojë në zekat, kjo gjë nuk i pranohet dhe ai me këtë nuk e kryen detyrimin për dhënien e zekatit.

Përfitimet e rregullës së qëllimit

Rregulli i qëllimit ka përfitime të shumta, mirëpo kryesoret janë pesë:

1. Dallohet qëllimi i veprës.

- Në qoftë se nëpërmjet një veprë kërkohet kënaqësia e Allahut, atëherë ai është ihlasi (çiltëria).
- Në qoftë se nëpërmjet saj synohen lëvdatat e njerëzve, atëherë kjo vepër është e bërë për sy e faqe (rija).
- Në qoftë se një vepër, që është ibadet (adhurim) bëhet për dikë tjetër pos Allahut, atëherë kjo është shirk i madh.

2. Dallohen ibadetet nga zakonet.

Shembull:

- Dallohet lënia e ushqimit dhe e pirjes gjatë ramazanit nga lënia e tyre për t'i bërë analizat e gjakut ose thjesht për dietë.
- Gusli (larja e tërësishme e trupit) që bëhet për t'u pastruar nga xhunubllëku dallohet nga dushi që bëhet me qëllim freskimi.

3. Dallohen ibadetet që janë të njëjta në dukje.

Shembull:

- Dallohet suneti i namazit të sabahut nga farzi i namazit të sabahut.
- Dallohet agjërimi vullnetar nga agjërimi që bëhet për të kompensuar ndonjë ditë të ramazanit.

4. Shndërrimi i zakoneve të lejuara në ibadete.

Shembull:

- Ngrënia, pirja dhe fjetja bërë me qëllim të marrjes së energjisë për ta adhuruar Allahun e Lartësuar.
- Shpenzimi i pasurisë për veten, për bashkëshorten dhe për fëmijët, duke llogaritur në shpërblimin e Allahut të Madhërishëm.

5. Përcaktimi i vlefshmërisë dhe pavlefshmërisë së ibadeteve.

Për shembull ibadetet, fjala vjen, abdesi, namazi, haxhi, zekati, e kështu me radhë, nuk janë të vlefshme në qoftë se u mungon nijeti.

Çdo rregull e përgjithshme mund të specifikohet

Nëse ndodh që ndonjë dispozitë të jetë në kundërshtim me ndonjë rregull, ai rregull nuk ka ndikim sepse ajo ndodhi është ndodhi e rrallë, ndërsa ndodhia e rrallë nuk bën pjesë në rregullin e përgjithshëm.

EL MEKAASID VEL IËTTIKADAAT MUËTEBERETUN FIT- TESARRUF VEL IBAARAAT KEMAA HIJE MUËTEBERETUN FIL KURUBAAT VEL IBAADAAT

2. Qëllimi dhe nijeti llogariten në veprime dhe deklarime ashtu siç llogariten në shpërblime dhe adhurime.

1. Lejohet prerja e kafshës me nijet konsumimi, ndërsa nuk lejohet nëse prehet jo në emër të Allahut.

2a. Ai i cili nuk është në ihram të haxhit, nëse e gjuan për atë i cili është në ihram, e ka të ndaluar të konsumojë. Ndërsa nëse e gjuan për atë i cili nuk është në ihram, lejohet ta konsumojë edhe ai i cili është në ihram të haxhit.

2b. Ai i cili nuk është në ihram të umres, nëse e gjuan për atë i cili është në ihram, e ka të ndaluar të konsumojë. Ndërsa nëse e gjuan për atë i cili nuk është në ihram, lejohet ta konsumojë edhe ai i cili është në ihram të umres.

3a. Nëse i jep borxh një njeri njeriut tjetër një monedhë ari për një afat të caktuar. Kjo llogaritet shpërblim.

3b. Nëse një njeri i shet një njeriu tjetër një monedhë ari për një monedhë ari për një afat të caktuar, ka mëkat për atë qëllim.

- Në qoftë se një person ia dhuron një tjetri njëqind euro, pastaj e merr vesh se ia ka borxh njëqind euro personit që ia ka dhuruar ato para, në këtë rast nuk numërohet se ia ka kthyer borxhin, sepse ai ia ka dhënë ato para si dhuratë dhe jo si kthim borxhi.

4. Shtrydhja e rrushit për qëllim të alkoolit nuk lejohet, ndërsa shtrydhja e rrushit për qëllim të përfitimit të thartirës apo për lëng joalkoolik lejohet.

5a. Nëse burri i thotë gruas: “Ti je si nëna ime” me qëllim të nderimit, kjo lejohet.

5b. Nëse burri i thotë gruas: “Ti je si nëna ime” me qëllim të DHIHARIT, kjo nuk lejohet.

6a. Nëse njeriu abstenon nga ushqimi, pija dhe çështjet e ndaluara të agjërimit dhe me këtë nuk ka për qëllim afrimin tek Allahu, por ka qëllim shërimin a dietën, kjo nuk llogaritet agjërim dhe për këtë nuk ka shpërblim.

6b. Nëse njeriu abstenon nga ushqimi, pija dhe çështjet e ndaluara të agjërimit me qëllim që t’i afrohet Allahut, kjo llogaritet agjërim dhe për të shpërblehet.

- Kush sillet rreth Qabës, por jo me qëllim të tavafit, nuk llogaritet TAVAF.

- Kush i jep të varfrit sadaka dhe nuk e bën nijet për zekat nuk llogaritet zekat.

- Nëse një person i jep dikujt pasuri duke e pasur për qëllim lëmoshën vullnetare, e më pas të njëjtën dëshiron ta shndërrojë në zekat, kjo gjë nuk i pranohet dhe ai me këtë nuk e kryen detyrimin për dhënien e zekatit.

- Kush i jep të varfrit dhuratë dhe nuk e bënë nijet për zekat, nuk llogaritet zekat.

- Kush qëndron në xhami dhe nuk e bën nijetin e IËTIKAFIT nuk llogaritet IËTIKAF.

Këtë rregull mund ta hasim edhe në formulimin “Pa nijet nuk ka shpërblim dhe “Nijeti është kusht për vlefshmërinë e veprave.”

EL- IBRETE FIL UKUUD LIL MEKAASID VEL MEAANIJ LA LIL ELFAADH VEL MEBAANIJ

3. Në akte llogaritet qëllimi dhe kuptimi, ndërsa nuk llogaritet fjala dhe konstrukti i fjalës.

Shpjegim i termave

Fjala **UKUD** shumësi i i fjalës **AKD** ka kuptimin e *pajtimit në mes të ofertës dhe pranimit të ofertës* si f.v.:

- akti i martesë;
- akti i qirasë;
- akti i shitblerjes, etj.

Formula e aktit

Formula e aktit përbëhet prej ofertës dhe pranimit (të ofertës), shembull:

- ofroj shitjen e këtij malli,
- pranoj blerjen e këtij malli.

Fjala **Lefdh** është fjalë të cilën e thotë njeriu me qëllim të shprehjes së asaj që e ka në zemër.

Fjala **el-Mekasid** shumësi i fjalës **meksad** ka kuptimin e *dëshirës dhe njetit*.

Fjala **Meani** d.t.th. *tregueshmëria e shprehjes*. Çdo fjalë mund të ketë më shumë se një kuptim.

Fjala **Mebani** d.t.th. *fjalja e plotë ku secila fjalë në fjali e forcon njëra- tjetrën*.

Shembull:

Nëse një person i thotë personit tjetër: Po ta dhuroj këtë për 100 euro.

Ky lloj akti nuk është akt i dhuratës, por është akt i shitblerjes. Nga ky akt rezultojnë ligjet e shitblerjes: pagesa e mallit dhe dorëzimi i mallit, ose mosdorëzimi i mallit nëse nuk bëhet pagesa.

Nëse një person i thotë personit tjetër: Të kam shitur këtë me pa të holla. Shitblerja është e pavlefshme dhe ky akt nuk llogaritet dhuratë, sepse nuk është sqaruar qëllimi.

KAPITULLI I DYTË

Ligji ndërtohet mbi çështjen e sigurt dhe nuk ndërtohet me të dyshimtën. Edhe argumentet të cilat i vendosin ligjet duhet të jenë të sigurta dhe jo të dyshimta.

Në këtë kapitull janë paraparë tetë rregulla:

1. E dyshimta nuk e zhvlerëson të sigurtën.
2. Në esencë çdo gjë mbetet siç ka qenë.
3. Esenciale të mbetet çështja ashtu siç ka qenë, deri sa të mos vërtetohet se është ndryshuar.
4. Ligji i gravitimit dhe largimi i dyshimit dhe gjykimit se çdo gjë mbetet siç ka qenë.
5. Te çështjet, esenciale është lejimi.
6. Esenciale në të drejta është mosobligueshmëria.
7. Në esencë ndodhia e re i përshkruhet kohës më të afërt.
8. Të sigurtat nuk kundërshtohen në mes vete.

EL JEKINË LAA JEZUULU BI SHEKK

1. E dyshimta nuk e zhvlerëson të sigurtën.

Shpjegimi i termave

Në etimologji fjala **shekk** (dyshim) domethënë *ngatërrim*, ngaqë atij që ka mëdyshje i janë ngatërruar dy çështje, rrjedhimisht nuk e di se cila nga ato është e sakta.

Në terminologji fjala **shekk** (dyshim) nënkupton *mëdyshjen përndodhjen a mosndodhjen e diçkaje*.

Në etimologji fjala **jekinë** nënkupton *bindje, siguri dhe palëkundshmëri*. Me këtë fjalë është për qëllim *dija e padyshimtë*.

Në terminologji fjala **jekinë** nënkupton *qetësimin e zemrës dhe palëkundshmërinë e dijes në të*.

Jekinë e quajmë edhe *besimin e paluhatshëm*.

Argument

Argument për këtë rregull është hadithi që e përcjell Abdullah ibn Zejd ibn Asim El-Maziniju r.a. i cili thotë se dikush i është ankuar të Dërguarit a.s. se nganjëherë njeriut i duket se i del diçka nga trupi gjatë namazit.

I Dërguari, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, i është përgjigjur:

“Të mos dalë nga namazi pa dëgjuar zë ose pa ndier erë.”

Kuptimi i rregullës

Nëse njeriu gjendet në mëdyshje për ndonjë çështje pasi të ketë qenë i bindur, nuk duhet t'i kushtojë rëndësi dyshimit, por duhet të gjykojë në bazë të bindjes paraprake. Kjo nënkupton se nuk hiqet ligji i saj me hamendje.

- Kush është i bindur se ka marrë abdes, pastaj hamendet se mos e ka prishur, gjykohet se ai është me abdes.

- Kush dyshon në pastërtinë e ujit se mos është ndotur me pak ndyrësirë apo me shumë, esenciale është se ai ujë është i pastër.

Ligj për të ligjësuar një çështje apo për ta mohuar atë për të tashmen ose për të ardhmen, duke e marrë për bazë ligjësimin apo mohimin në kohën e kaluar, për shkak të mosekzistimit të ndonjë argumenti për ndryshim.

Shembuj:

- Nëse ndokush dëshiron të agjërojë, mirëpo ha duke qenë në mëdyshje se a ka aguar mëngjesi apo jo dhe nuk i bëhet e qartë një gjë e tillë, atëherë agjërimi i këtij njeriu është i vlefshëm, sepse parimisht mbetet që nata të mos ketë kaluar.

- Nëse dikush e di që e ka prishur abdesin, mirëpo dyshon se a ka marrë abdes më pas apo jo, atëherë gjykojmë se ky njeri nuk ka abdes, sepse parimisht mbetet që ai nuk ka abdes.

- Ai që është i bindur se ka marrë abdes, mirëpo ka rënë në mëdyshje se a e ka prishur abdesin apo s'e ka prishur, konsiderohet se ka abdes.

- Nëse ndokush dyshon se a e ka falur një namaz të caktuar apo s'e ka falur, atëherë ai është i detyruar ta falë atë, ngaqë ai dyshon në kryerjen e namazit, kurse në parim duhet gjykuar se nuk e ka falur namazin, kështu që përgjegjësia e tij nuk bie derisa të sigurohet se e ka falur namazin.

- Nëse një person merr abdes dhe falë namaz pastaj dyshon se a e ka prish abdesin apo jo, ai duhet të falet sepse abdesi për të është më i sigurt, ndërsa prishja e abdesit për të është çështje e dyshimtë, ndërsa e sigurt ka përparësi nga e dyshimta. Muhamedi a.s. ka thënë:

“Kush ndien vështirësi në lukth dhe dyshon a i ka dalë diçka nga lukthi apo jo, të mos dalë nga xhamia derisa të dëgjoj zë apo të nuhatë erën e lukthit”.

- Kush dyshon në pastërtinë e ujit se mos është ndotur me pak ndyrësi apo me shumë, esenciale është se ai ujë është i pastër.

- Kush ha në mesnatë dhe dyshon në agimin e ditës, agjërimi i tij është i plotë sepse esenciale është nata, nata është e sigurt, ndërsa agimi i dyshimtë.

- Kush ha në fund të ditës, pa bërë ndonjë hulumtim dhe dyshon në perëndimin e diellit, agjërimi i tij priset sepse esenciale është dita dhe dita është e sigurt ndërsa perëndimi i diellit i dyshimtë.

Përfundim

Nga ky rregull përjashtohet ai që është i sprovuar me vesvese. I tilli nuk ia vë veshin dyshimit.

EL- ES LU BIKAAE MAA KANE ALAA MAA KAANE

2. Në esencë çdo gjë mbetet ashtu siç ka qenë.

Shpjegimi i termit

Fjala **esencë** ka kuptimin e *argumentit*, që do të thotë se nëse ndodh një papajtueshmëri për diçka, vendoset si argument.

Këtë rregull mund ta definojmë edhe në këtë mënyrë: “**Çështje esenciale është që gjendja e Çështjeve të mbetet në gjendjen e tyre fillestare**”.

Dijetari fillon prej gjendjes fillestare të Çështjes, pastaj merr vendim në bazë të gjendjes fillestare të asaj Çështjeje deri sa nuk paraqitet ndonjë dëshmi apo argument për të kundërtën e saj.

Shembull:

Në esence uji është i pastër, nga shkaku se Zotit i Lartmadhëruar ka thënë:

“dhe Ne e kemi zbritur nga qielli ujin e pastër”.

Po ashtu Muhamedi a.s. ka thënë:

“Uji është i pastër.”

- Nëse një person gjen ujë dhe dyshon në pastërtinë e tij, ai vepron me esencën e ujit si i pastër dhe e largon dyshimin ashtu që e përdorë ujin si ujë të pastër për abdes dhe gusul, në arsyetimin e saj se *çështja fillestare mbetet në gjendjen fillestare*.



- Nëse një person e padit një person tjetër se i ka dhënë borxh dhe personi tjetër nuk e pranon një padi të tillë, ndërsa personi në fjalë (peditësi) nuk paraqet fakte dhe dëshmi, atëherë çështja mbetet se nuk i ka dhënë borxh.

- Nëse blerësi e padit shitësin se ia ka paguar vlerën e mallit dhe shitësi nuk e pranon një padi të tillë, ndërsa blerësi nuk paraqet fakte dhe dëshmi, atëherë çështja mbetet se nuk ia ka paguar vlerën e mallit.

- Nëse një person pretendon se tjetri i ka borxh, ai duhet të sjell dëshmi se i akuzuari i ka borxh, nëse nuk mund ta vërtetojë me dëshmi, personi tjetër shpallet i pafajshëm sepse *esenciale është pafajësia derisa akuzuesi të mos sjell dëshmi* se i ka dhënë borxh.

EL ESLU BIKAAE MAA KAANE HATTA JUTHBITU MAA JUGAJJIRIHUU

3. Esenciale të mbetet çështja ashtu siç ka qenë, deri sa të mos vërtetohet se është ndryshuar.

Shembull: Personi i pagjetur (i humburi).

Esenciale është se ai është i gjallë deri sa të mos vërtetohet se ka vdekur.

Istis'habi i gjendjes së tanishme vërteton dy të drejta, të drejtat pozitive dhe të drejtat negative, përderisa nuk sillet argument i cili ndalon vazhdimësinë.

Gjendja e të pagjeturit për të cilin kalon një kohë e gjatë dhe nuk gjendet asnjë gjurmë prej tij:

Nuk i zbatohen të drejtat pozitive, si f.v., trashëgimia nga tjetri, por i rezervohen vetëm të drejtat negative. Do të thotë se i mbetet pronësia e tij, çka ka qenë para zhdukjes.

Ligji i istis'habit të tij rezulton vetëm që të jepet prej tij çka rezulton prej vdekjes si ndarja e pasurisë së tij trashëgimtarëve, dhe nuk rezulton që pasuria e tjerëve t'i kalon atij.

Gjykohet në favor të gjallërisë së tij përgjatë kohës së zhdukjes vetëm sa i përket pasurisë dhe bashkëshortes së tij, kjo deri sa të paraqitet argument për vdekjen e tij ose deri sa gjykatësi të shpallë “de jure” vdekjen e tij.

I zhdukuri është gjallë për veten e tij, ndërsa i vdekur për të tjerët. As nuk trashëgon prej tjerëve dhe as nuk trashëgohet, nuk i rezervohet hisja e tij dhe nuk lejohet që të shpërndahet pasuria e tij te trashëgimtarët e të vdekurit sepse istis'habi nuk vlen si argument për të prodhuar të drejta të reja përfituese, që do të thotë se është argument për të mënjeluar të drejtat, saqë pasuria e tij nuk trashëgohet dhe nuk vlen për të përfituar të drejtat, kështu që nëse një i afërm i tij vdes, i zhdukuri nuk trashëgon, e kjo nga mundësia se ai mund të ketë vdekur.

Në shkencën e Usulit ky rregull quhet argumenti i Gravitimit.

Istis'habli hal ve tarhi shekk ve terk ilaa maa kaane alaa maa kaane

4. Ligji i gravitimit dhe largimi i dyshimit dhe gjykimit se çdo gjë mbetet siç ka qenë.

Istis'hab quhet ligjësimi për një send në atë gjendje siç ka qenë më parë, deri sa të gjendet ndonjë argument për ndryshimin e tij.

Me fjalë tjera:

Marrjen e mendimit siç ka qenë e kaluara të mbetet edhe tani, deri sa të mos shohim argumentin i cili e ndryshon.

Ky lloj burimi ka të bëjë me normën e cila në fakt ka ekzistuar më herët, mirëpo dyshohet në mos ekzistimin e saj dhe si e tillë gjykohet se ajo normë vazhdon deri sa nuk silllet dëshmia e kundërt.

Po ashtu edhe e kundërta, kur mendohet se diçka nuk ka ekzistuar më herët, por dyshohet se ekziston, kështu që vazhdohet të gjykohet se nuk ekziston derisa nuk dëshmohet e kundërta e saj.

Ky burim ndahet në tri lloje:

1. Rezonimi i cili dëshmon se norma e çdo gjëje, në bazë është e lejuar për t'u zbatuar përderisa nuk vjen ndonjë normë tjetër që e bën të ndaluar, dhe anasjelltas.

2. Rezonimi i cili dëshmon për pafajësi juridike, p.sh.,

- agjërimi i muajve të tjerë përveç muajit ramazan: personi nuk mund të agjërojë dhe është i pafajshëm përderisa nuk dëshmohet ajo normë.

3. Rezonimi për të cilin dëshmon logjika dhe e drejta e Sheriatit për vazhdueshmërinë dhe ekzistimin e asaj që ka qenë më herët, p.sh., një person ka marr abdes dhe pas pak dyshon në abdesin e tij, në këtë rast dëshmohet se ka abdes duke u bazuar në faktin se ka pasur abdes më herët.

EL ESLU FIL ESHJAAË IBAANA

5. Te çështjet, esenciale është lejimi.

Të gjitha çështjet janë të lejuara deri sa të sillet argument për ndryshimin e tyre. Zoti i Lartmadhëruar ka thënë:

“Dhe ua ka nënshtruar çka ka në qiej dhe në tokë”. (El Xhathije,13)

“Ai Allahu është i Cili ka krijuar për ju gjithçka ka në qiej dhe në tokë”. (El Bekare, 29)

Shembull:

Nëse parashtrohet pyetja për një çështje, e cila nuk gjendet në Kur'an, as në sunet, as nuk ka ligj për të,

përgjigjja për të është se: është e lejuar.

Parashtrohet pyetja tjetër: Pse është e lejuar?

Përgjigjja është: **Esenciale e çështjeve është lejimi i tyre.**

Nëse parashtrohet pyetja për ngrënien e mishit të ndonjë kafshe për të cilin nuk ka argument as për lejim e as për ndalim, atëherë përgjigjja është se: është e lejuar.

Nëse parashtrohet pyetja për ngrënien e ndonjë bime për të cilin nuk ka argument as për lejim e as për ndalim, atëherë përgjigjja është se: është e lejuar.

Çdo çështje përderisa nuk sillet argument prej teksteve të sheriatit se ndalohet, ajo çështje është e lejuar, as nuk fajësohet vepruesi dhe as nuk penalizohet.

Arsyetimi është rregull i istis'habit

“Esenciale për çdo çështje është lejimi deri sa të sillet argument për ndryshimin e asaj çështje.”

- Nëse një person është i gjallë, merret vendim se ai është i gjallë deri sa të argumentohet vdekja e tij sepse gjallëria e tij është e sigurt, ndërsa vetëm zhdukja e tij nuk dëshmon se ai është i vdekur.

- Rezonimi i cili dëshmon se norma e çdo gjëje në bazë është e lejuar për t'u zbatuar përderisa nuk vjen ndonjë normë tjetër që e bën të ndaluar dhe anasjelltas.

- Vlefshmëria e kontratës ose shfrytëzimi i çështjes deri sa të sillet nga Ligjvënësi argument që tregon për pavlefshmërinë apo prishjen e tij.

Istis'habi është hapi i fundit të cilin duhet ta bëjë muxhtejadi në zgjidhjen e çështjes.

EI ESLU BERATE DHIMETI

6. Esenciale në të drejta është mosobligueshmëria.

Shembull:

- Ai që dyshon a ka bërë ndonjë betim për të cilin duhet të japë shpagim apo jo, nuk detyrohet me shpagim, sepse në parim njeriu është i lirë nga kjo përgjegjësi.

- Nëse ndokush pretendon për dikë tjetër se i ka borxh dhe nuk sjell argument për atë që thotë, atëherë i akuzuari nuk detyrohet me atë borxh, sepse në parim ai është i lirë, gjegjësisht i pastër nga kjo përgjegjësi.

- Nëse një person (paditësi) pretendon se tjetri i ka borxh, ai duhet të sjell dëshmi se i akuzuari i ka borxh, kurse nëse nuk mund ta vërtetoj me dëshmi, atëherë personi tjetër (i padituri) shpallet i pafajshëm sepse esenciale është pafajësia derisa akuzuesi të mos sjell dëshmi se i ka dhënë borxh.

Nuk lejohet që një çështje t'i ngarkohet një personi ose të bashkëngjitet pos me argument, përderisa për mohim (moskryerje apo mosveprim) nuk ka nevojë për argument, kjo është bazë juridike.

Nëse një person kërkon të drejtën e tjetrit ai duhet të sjell dëshmi, nëse nuk sjell dëshmi nuk gjykohet në favor të tij sepse **më mirë është të mos gjykohet një fajtor se sa të ndëshkohet një i pafajshëm.**

Rregulli: **“Në parim çdokush është i lirë nga përgjegjësia.”** konsiderohet edhe rregull e shkencës së usulit.

Rregulli: **“Në parim gjërat janë të pastra.”** konsiderohet edhe rregull e shkencës së usulit.

7. Në esencë ndodhia e re i përshkruhet kohës më të afërt.

Shembull:

- Ai që sheh spermë në rrobat e tij duke mos iu kujtuar kur e ka parë endrrën (që ia ka obliguar guslin), (pasi të lahet) duhet t'i përsërisë vetëm namazet që i ka falur pas gjumit të fundit. Kështu, duke ia përshkruar këtë ngjarje kohës më të afërt, sepse parimisht duhet marrë se ajo nuk ka ndodhur para kësaj kohe.

- Ai që sheh në dorën e tij diçka që e pengon depërtimin e ujit në lëkurë, siç janë llaku, fshirësja e ngjyrës dhe rrëshira, duhet të marrë abdes pasi ta largojë atë dhe t'i përsërisë ato namaze që i ka falur nga koha më e afërt që i ka përdorur këto lëndë. Kjo për faktin se prania e këtyre gjërave i përshkruhet kohës më të afërt të mundshme, për shkak se parimisht mbetet që ato nuk kanë qenë të pranishme para kësaj kohe.

Kjo gjë vlen në qoftë se janë terur gjymtyrët e trupit pas abdesit ose ka kaluar kohë e gjatë që kur ka marrë abdes, sepse poqëse nuk janë terur ende gjymtyrët ose nuk ka kaluar kohë e gjatë që kur ka marrë abdes, atëherë ai e heq pengesën dhe e pastron pjesën e gjymtyrës ku ka qenë pengesa dhe pastaj e plotëson abdesin, duke i pastruar gjymtyrët që vijnë pas saj në renditje, derisa ta përfundojë abdesin.

- Nëse ndokush dyshon në pastërtinë e vendit ku falet, atëherë në parim ai vend konsiderohet i pastër, derisa të marrim vesh se në atë vend ka rënë ndonjë ndyrësi.

LAA TEARUD FIL JEKINIJAAT

8. Të sigurtat nuk kundërshtohen në mes vete

Në sheriatin islam, argumentet e prera dhe të sigurtat asnjëherë nuk mund të kenë mospajtime mes vete.

Në argumentet jo të prera dhe të pasigurtat mund të ketë mospajtime dhe këto argumente mund të kundërshtohen në mes vete.

Nëse në dy të sigurtat paraqiten mospajtime dhe kundërshtime për një Çështje, atëherë veprohet me njëren prej tyre duke i dhënë prioritet njëres prej tyre, nga shkak se është e pamundur që dy të kundërta (të sigurtat) të bashkohen në një Çështje, ndërsa të vepruarit me dy të kundërta pa i dhënë ndonjëres prioritet është e padrejtë:

- Nëse nuk mund t'i jepet përparësi njëres prej dy të kundërtave, duhet stopuar deri sa të gjendet çfarëdo fakti i cili vërehet në njëren prej tyre, në mënyrë që t'i jepet përparësi njëres prej tyre.

- Nëse nuk mund t'i jepet përparësi njëres prej dy të kundërtave, ka mendime se veprohet me njëren prej tyre, duke e zgjedhur në mënyrë të lirë.

Kusht i të vepruarit me argumentet jo të prera dhe jo të sigurtat që kundërshtohen ndërmjet vete është që njëres t'i jepet prioritet.

Ky rregull në një aspekt është rregull e Usuli Fikhut, ndërsa në një aspekt tjetër është rregull e Fikhut.

- Nga aspekti i këndvështrimit të argumenteve të kundërta dhe preferimit të njëres prej tyre me fakt mbështetës (fakte shtesë) quhet rregull e Usuli Fikhut.

- Nga aspekti se cilës i jep përparësi muxhtehidi për të vepruar në bazë të fakteve të dëshmuara llogaritet rregull Fikhore.

KAPITULLI I TRETË

Feja Islame është e ndërtuar mbi bazën e lehtësimit dhe tolerancës, largimin e të dëmit dhe të keqes dhe vështirësisë.

Zoti i Lartmadhëruar ka paraparë rrugëzgjdhje për çdo problem.

Lehtësimi në raste të vështirësive buron nga Kur'ani dhe suneti, dhe rregullat ndërtohen mbi këta baza.

Në këtë kapitull kemi paraparë shtatë rregulla fikhere, e ato janë:

1. Dëmi nuk largohet me dëmtim.
2. Dëmi më i madh largohet me dëmin më të vogël.
3. Kur të paraqiten dy të këqija, prej dy të këqijave veprohet me të keqën më të lehtë.
4. Nuk ka obligueshmëri në pamundësi dhe nuk ka ndalesë në rast domosdoshmërie.
5. Vështirësia nuk lejon të drejtën e tjetrit.
6. Dëmi individual duhet të përballohet për t'u mënjanuar dëmi i përgjithshëm.
7. Dëmi eliminohet në bazë të mundësive.

EDDARARU LAA JUZAALU BID-DARAR

1. Dëmi nuk largohet me dëmtim.

Kjo rregull ndërlidhet me rregullat tjera të Fikhut:

- Dëmi nuk lejohet me të njëjtin dëm.
- Dëmi nuk largohet me dëm më të madh dhe më të rëndë.
- Dëmi largohet me dëmtim më të lehtës si f.v.:

Mjeku e operon pacientin pasi që e di se dëmi i operacionit është më i lehtë në krahasim me dëmin të cilin e përjeton në rast mosoperimi.

Kjo rregull është përcaktim i rregullës *dëmi largohet*.

Shembull:

- Një dhomë e pronësojnë dy persona dhe njëri prej tyre dëshiron që dhoma të ndahet. Ajo dhomë nuk mund të ndahet për shkak të hapësirës së vogël, dhe ndarja e dhomës do ta bënte dhomën jofunksionale.

Pasiqë përgjysmimi shkakton dëm, e **dëmi nuk largohet me dëmtim**, andaj nuk gjykohet për përgjysmim, se atëherë humb funksionaliteti i dhomës, por gjykohet shitja e dhomës njërit prej pronarëve.

Edhe shitja është dëmtim, por dëmi është më i vogël, kështu që **dëmi më i madh largohet me dëmin më të vogël**.

- Nuk lejohet që dikush ta shpëtojë veten duke ia marrë ushqimin atij që po ashtu i nevojitet për ta shpëtuar jetën e tij.

- Askujt nuk i lejohet t'ia marrë rrobat tjetrit për t'i mbuluar pjesët e turpshme të trupit, në qoftë se edhe atij i nevojiten për t'i mbuluar pjesët e turpshme të trupit.

ED DARARU ESHED JUZAAL BI DARARIL EHAf

2. Dëmi më i madh largohet me dëmin më të vogël

Ky rregull bazohet në rregullin **Dëmi largohet**.

Ky rregull është sqarim dhe specifikim i rregullit: **Dëmi nuk largohet me dëmtim**.

Nëse është e patjetërsueshme që dëmi duhet larguar me dëmtim, atëherë duhet që dëmi më i madh të largohet me dëm më të vogël.

Nëse dëmi i cili largon dëmin është i njëjtë me dëmin të cilin duhet larguar atëherë zgjedhim:

- ose të mbetet dëmi;
- ose e largojmë me të njëjtin dëm.

Nëse dëmi i cili e largon dëmin është më i madh se dëmi i cili duhet larguar, nuk lejohet as ligjërisht dhe as logjikisht të bëhet një veprim i tillë.

Dëmi përcaktohet duke shikuar kushtet, rrethanat, individët dhe zakonet. Duhet të merren parasysh të gjitha këto çështje në mënyrë që të gjykohet me drejtësi dhe me urtësi.

Kur dy të këqija ndodhen në të njëjtën kohë lejohet që të veprohet e keqja më e vogël për të larguar të keqen më të madhe:

Shembull:

- Lejohet të pranohet shpërblimi për thirrje të ezanit sepse po të mos thirret ezani, atëherë dëmi do të ishte edhe më i madh.

- Lejohet të pranohet shpërblimi për imam (edhe pse është i ndaluar pranimi i pagës për imam) sepse po të mos kishte imam, atëherë e keqja do të ishte edhe më e madhe.

- Lejohet të jepet mësim fikhu me pagesë edhe pse në përgjithësi është i ndaluar pranimi i pagesës për mësim të fikhut, por lejimi bëhet sepse po të mos kishte mësues të fikhut atëherë e keqja do të ishte edhe më e madhe.

Sa i përket largimit të dëmit, ai duhet të ketë prioritet nga realizimi i dobisë. Pra, kur takohen largimi i dëmit dhe realizimi i dobisë, zgjidhet largimi i dëmit.

IDHAA TEAAREDAT MUFSIDETANI REVAA EADHAMUHUMA DARAREN BI IRTIKAABI EHAFUHUMAA

3. Kur të paraqiten dy të këqija, prej dy të këqijave veprohet me të keqën më të lehtë.

Nëse paraqiten dy të këqija:

- Ose janë të njëjta;
- ose njëra është më e keqe se tjetra.

1. Kur dy të këqija janë të njëjta.

Nëse dy të këqija janë të njëjta, nuk lejohet që njëra prej të këqijave të largohet me tjetrën dhe anasjelltas.

2. Kur njëra prej të këqijave është më e rëndë se tjetra.

Nëse njëra prej dy të këqijave është më e rëndë se tjetra, atëherë me më të keqën më të lehtë largohet e keqja më e rëndë.

Shembull:

- Nëse një musliman e sheh një të keqe, por e parasheh se ndryshimi i asaj të keqe sjell të keqe më të madhe, atëherë nuk duhet ta largoj atë të keqe dhe nuk parapëlqehet që ta largoj, madje përkundrazi nëse largimi i asaj të keqe sjell të keqe më të madhe, atëherë largimi i kësaj të keqe është i ndaluar.

- Nëse një musliman e sheh një të keqe, por e parasheh se ndryshimi i asaj të keqe sjell të keqën më të lehtë, ai e ka për obligim ta largoj atë të keqe.

- Mjeku i cili duhet ta operoj pacientin, para se ta operoj duhet të shikojë rezultatin e operacionit:

- Nëse e sheh se operacioni është më i dobishëm, e operon pacientin.

- Nëse e sheh se operacioni është më i dëmshëm se vet shërimi, nuk e operon pacientin.

Përcaktimi i dëmit dhe dobisë shikohet në bazë të ligjit, e jo në bazë të dëshirave dhe mendimit të pabazuar.

Dëmi dhe dobia duhet shikuar në dritën e Kur'anit dhe sunetit.

E mirë është ajo çka Allahu e ka paraparë të mirë dhe jo ajo që e parasheh dëshira dhe mendja e njeriut.

E keqe është ajo çka Allahu e ka paraparë të keqe dhe jo ajo që e parasheh dëshira dhe mendja e njeriut.

Çdo e keqe e cila largohet rezulton të mirën në vetvete. Ligjet e sheriatit janë të ndërtuara mbi bazën e largimit të dëmit dhe realizimit të dobisë dhe sikurse bien ndesh të mirat në mes vete ashtu bien ndesh në mes vete edhe të këqijat, kështu që kur takohen dy të mira, i jepet prioritet të mirës më të madhe ndaj të mirës më të vogël dhe po ashtu në paraqitjen e dy të këqijave, largohet e keqja më e madhe para të keqes më të vogël.

LAA VAAXHIBE MEAL AXHZI VE LAA HARAAME MEA DARUURETI

4. Nuk ka obligueshmëri në pamundësi dhe nuk ka ndalesë në rast domosdoshmërie.

Kjo rregull është e ndërtuar mbi bazat e përgjithshme kur'anore.

Pjesa e rregullit **“Nuk ka obligueshmëri në pamundësi.”** është e ndërtuar mbi thënien e Zotit të Lartmadhëruar:

“Allahu nuk e ngarkon askënd pos sa ka mundësi.”

Pjesa tjetër e rregullës **“Nuk ka ndalesë në pamundësi.”** është e ndërtuar mbi bazën e ajetit të Kur'anit fisnik:

“Dhe kush është i detyruar pa dëshirën e tij dhe nuk tejkalon, nuk ka mëkat për të.”

Për këtë arsye me të drejtë thuhet: **Kandar i devotshmërisë është mundësia dhe kapaciteti.** Po ashtu edhe dijetarët kanë thënë: **“Obligueshmëria për të pamundurën është absurditet.”**

Shembuj të pjesës së parë të rregullit, pjesës “Nuk ka obligueshmëri në pamundësi”:

- Detyra e kryerjes së haxhit bie për personin që nuk ka mundësi materiale ta kryejë atë.

- Nëse dikujt i është prerë dora dhe nuk i ka mbetur asnjë pjesë e kësaj gjymtyre që duhet larë gjatë abdesit, atëherë për të bie detyra e larjes së asaj pjese dhe nuk kërkohet zëvendësim për të.

- Nëse dikujt i është prerë këmba dhe nuk i ka mbetur asnjë pjesë e kësaj gjymtyre që duhet larë gjatë abdesit, atëherë për të bie detyra e larjes së asaj pjese dhe nuk kërkohet zëvendësim për të.

- Ai që nuk ka mundësi ta lajë njëren dorë gjatë abdesit ose t'i japë mes'h, detyrohet t'i lajë të gjitha gjymtyrët e tjera të abdesit që mund t'i lajë dhe të marrë tejemum për pjesën që nuk ka mundësi ta lajë a t'i japë mes'h.

Dora e prodhuar në fabrikë nuk duhet larë, përveç nëse i ka mbetur ndonjë pjesë nga gjymtyrët e abdesit, atëherë e lanë pjesën e mbetur, në qoftë se ekziston mundësia. Atij nuk i lejohet ta lërë abdesin dhe të marrë tejemum për të gjitha gjymtyrët e abdesit.

Këmba e prodhuar në fabrikë nuk duhet larë e as nuk duhet dhënë mes'h, përveç nëse i ka mbetur ndonjë pjesë nga gjymtyrët e abdesit, atëherë e lanë pjesën e mbetur, në qoftë se ekziston mundësia. Atij nuk i lejohet ta lërë abdesin dhe të marrë tejemum për të gjitha gjymtyrët e abdesit.

- Ai që nuk mund të bjerë në ruku, porse mund të falet në këmbë, e ka për detyrë të falet në këmbë dhe, kur dëshiron të bjerë në ruku, të perkulet aq sa ka mundësi. Ndërkaq, nuk ka të drejtë të falet ulur, meqë ka mundësi të falet në këmbë.

Shembuj të pjesës së dytë të rregullit, pjesës “Nuk ka ndalesë në rast domosdoshmërie”:

Ky rregull rezulton nga pjesa e ajetit kur'anor:

“Dhe kush është i detyruar pa dëshirën e tij dhe nuk tejkalon, nuk ka mëkat për të.”

Për këtë arsye dijetarët kanë thënë: **Absurde është të obligohet njeriu të bëjë të pamundurën.**

Nëse njeriu ka uri vdekjeje dhe gjen dy dele:

- njëra është e prerë dhe
- tjetra e ngordhur,

në atë rast ai i jep përparësi njëres prej tyre edhe pse njëra dele është e lejuar, ndërsa tjetra është e ndaluar sepse të larguarit nga e ndaluara (harami) ka përparësi nga të afruarit e së lejuarës (hallallit).



- Nëse njeriu nuk mundet të rreshtohet në safin e fundit dhe nuk ka kush i bashkëngjitet dhe mbetet i vetëm në saf dhe nuk mund të hynë në rreshtin e fundit dhe falet i vetëm duke krijuar rresht të fundit si i vetëm, namazi i tij është i plotë dhe i rregullt dhe pranohet.

5. Vështirësia nuk lejon të drejtën e tjetrit.

Nëse një person gjendet në vështirësi jetike dhe domosdoshmërisht shkakton dëm në pasurinë e tjetrit, atëherë ai person dënohet me po atë dëm, në vlerë ose në rregullimin e dëmit.

Patjetërsueshmëria është dy llojesh:

1. Patjetërsueshmëria e brendshme;
2. Patjetërsueshmëria e jashtme.

1. Patjetërsueshmëria e brendshme shkaktohet nga faktorët e brendshëm si f.v.: uria, sëmundja, e të ngjashme.

2. Patjetërsueshmëria e jashtme shkaktohet nga faktorët e jashtëm.

Patjetërsueshmëria e jashtme është dy llojesh:

- a. Detyrimi absolut;
- b. Detyrimi relativ.

a. Te detyrimi absolut, dënohet detyruesi.

b. Te detyrimi relativ, dënohet i detyruari.

Përfundim nga ky rregull:

I detyruari edhe pse e ka të lejuar të veproj të ndaluarat, nëse e dëmton pronën e tjetrit dënohet në masën apo vlerën të cilën e ka dëmtuar.

Shembull:

- Nëse një person është i uritur me uri kritike, dhe hasë në ushqimin e tjetrit dhe ushqehet me atë ushqim, duhet t'ia kompensoj personit të ushqimit në të njëjtën vlerë të ushqimit.

- Nëse një person është në rrezik dhe për të kaluar rrezikun duhet ta dëmtoj pronën e tjetrit pa lejen e tij, ai person duhet të dënohet në masën e dëmit të cilën e ka shkaktuar.

JETEHAMMEL DARARUL HAAS LI DEF'ID - DARARUL AAMË

6. Dëmi individual duhet të përballohet për t'u mënjanuar dëmi i përgjithshëm.

Shembuj të këtij rregulli:

- Nëse muri i një personi privat gjendet afër rrugës dhe është në rrëzim e sipër, duhet të priset për të mënjanuar dëmin kolektiv.
- Lejohet përcaktimi (teësiri) i çmimeve nga qeveria në mënyrë që të mos lejohet që me anë të çmimeve të dëmtohet qytetari.
- Lejohet që të bëhet pengimi i ushtrimit të profesionit të mjekut për ata që nuk janë kompetentë.
- Nëse në pronë publike gjendet një pengesë, ajo pengesë hiqet edhe nëse ka qëndruar për një kohë të gjatë ashtu.
- Nëse një mur gjendet në mes të rrugës, priset, kjo bëhet për të mënjanuar rrezikun shoqëror.
- Lejohet vrasja e kusarëve (piratëve), plaçkitësve të rrugës, nëse dëmtojnë shoqërinë.
- Lejohet të vritet çdo vrasës i cili nuk mund të eliminohet ndryshe pos me vrasjen e tij.
- Lejohet burgosja e mjekut të padijshëm (sharlatan).
- Lejohet përdorimi i pronave private për të rregulluar shtratin e ndonjë lumi i cili mund të vërshojë, pasi që vërshimi e dëmton shoqërinë.

ED DARARU JUDFEA BI KADER IMKAAN

7. Dëmi eliminohet në bazë të mundësive

Shpjegimi i rregullit

Nëse ekziston mundësia dëmi eliminohet në tërësi, por nëse nuk mundet të eliminohet në tërësi, atëherë largohet në bazë të mundësisë, pra në pjesësi. Nëse mund të kompensohet në kundërvlerë, atëherë kompensohet me kundërvlerë.

Shembull:

Familja e të vrarit.

Nëse familja e të vrarit ia falin vrasësit, ndërsa njëri nuk ia falë, atëherë pjesa e këtij i cili nuk dëshiron të ia falë shndërrohet në kompensim me shumë materiale, me fjalë tjera, pjesë e DIJE-s.

Shembull tjetër:

- Uzurpatori i cili e uzurpon një pronë. Nëse ka mbet inventarë, kthehet inventari te i uzurpuari. Nëse një pjesë është dëmtuar, pason dëmshpërblimi.

- Nëse delen e ka prerë dhe e ka konsumuar, atëherë uzurpatori e kompenson me mjete materiale në vlerën e deles.

- Nëse ndonjë Çështje e ka dëmtuar me dëmtim të madh. Atëherë, i dëmtuari zgjedh për të kompensuar ose për të mbajtur atë inventar.

- Nëse ndonjë Çështje e ka dëmtuar me dëmtim të vogël. Atëherë i dëmtuari nuk ka të drejt zgjedhjeje, por vetëm i kompensohet ajo pjesë e dëmit të asaj Çështjeje.

KAPITULLI I KATËRT

Ligjet e sheriatit janë në përputhshmëri me interesin e shoqërisë dhe çështjet e reja të cilat paraqiten duhet të jenë në përputhshmëri me ligjet e sheriatit.

Në këtë kapitull janë paraparë pesë rregulla fikhere e ato janë:

1. Zakoni është ligj.
2. E përdorura në traditë është sikurse e kushtëzuara me kusht.
3. Ajo që është e njohur në mesin e tregtarëve është si të ishte kusht në mesin e tyre.
4. Ajo që është caktuar në bazë të zakonit është sikur të ishte e caktuar me tekst.
5. Nuk mohohet ndryshimi i dispozitave në bazë të ndryshimit të kohëve.

Përkufizimi i Traditës dhe Zakonit

Tradita dhe Zakoni është Çështje e cila përkujdeset për sigurimin e interesit shoqëror, interes i cili ndryshon me ndryshimin e kohës, vendit dhe rrethanave.

Ekzistojnë Çështje për të cilat dijetarët për të dhënë mendimin e tyre duhet t'i dinë traditat dhe zakonet e tyre, mendimet dhe veprimet e tyre.

Mendimet dhe veprimet e njerëzve bazohen në atë çka besojnë dhe e njohin njerëzit. Dhe nëse vendoset një ligj i cili nuk është në harmoni me atë çka e njohin njerëzit, atëherë ata vendosin në atë çka e njohin.

Ligjet e sheriatit të cilat burojnë nga Kur'ani dhe suneti janë ligje të cilat janë të përshtatshëm dhe të cilat nuk janë në kundërshtim me interesat e vazhdueshme të shoqërisë.

E drejta e traditës ndahet në dy lloje:

1. Traditat që janë të mira, të cilat nuk janë në kundërshtim me burimet e të drejtës së Sheriatit.
2. Traditat që janë në kundërshtim me të drejtën e Sheriatit.

E drejta e traditës për të qenë e ligjshme ndahet në katër lloje:

1. Tradita e cila është e përhapur tek muslimanët dhe nuk e refuzon askush, p.sh. traditë është të shpenzohet në ditët e festave.
2. Tradita e cila është e përhapur në ndonjë qytet apo në ndonjë fis, p.sh. traditat në mes qytetit të Gjilanit dhe Prishtinës me rastin e vdekjeve.
3. Tradita që ka të bëjë me përdorimin e shprehjeve, siç ndodhë rasti në viset e Kosovës.
4. Tradita e cila fillon të përhapet në një popull e që nuk ka ekzistuar më herët, por dalëngadalë bëhet e zakonshme.

Kushtet e traditës

Kushtet e traditës janë pesë:

1. Tradita e cila është e njohur në një bashkësi ose vend, dhe të mos jetë në kundërshtim me ndonjë normë të Sheriatit, me fjalë tjera Zakoni të jetë në përputhje të plotë me Sheriatin.
2. Tradita të jetë e njohur (pranuar) nga e gjithë bashkësia ose vendi, dhe të jetë asi ku të gjithë veprojnë sipas saj, ngase nëse nuk është e njohur si e tillë, atëherë sheriatit nuk e konsideron të ligjshme.
3. Tradita të jetë ende duke u përdorur nga masa sepse poqëse një traditë është përdorur më herët e tash jo, kjo traditë nuk konsiderohet e ligjshme.
4. Tradita të mos kundërshtohet nga populli.
5. Tradita të jetë e njohur nga komuniteti muslimanë dhe të pranohet nga konsensusi i komunitetit muslimanë.

EL ADETEU MUHAKEMETUN

1. Zakoni është ligj.

Në etimologji fjala **aadeh** (“adet” a “zakon”) rrjedh nga fjala **aud** që do të thotë **përsëritje**.

Në terminologji fjala **adet** nënkupton *një çështje që përsëritet te shumica e njerëzve ose te disa prej tyre, saqë bëhet e pranuar tek ata*. Pra, për ta nuk është diçka e panjohur a e çuditshme.

Fjala ‘**urf**’ gjuhësisht domethënë **vazhdimësi, shfaqje dhe qetësim**.

Në terminologji fjala ‘**urf**’ nënkupton *çdo fjalë, veprim ose lënie të diçkaje që është bërë shprehi e shumicës së njerëzve ose e një pjese të tyre*.

Shumica e fukahave, kur përdorin ndonjërin nga fjalët ‘urf’ dhe ‘adeh’, në të shumtën e rasteve nuk bëjnë dallim mes tyre.

Fjala **muhakkemeh** rrjedh nga fjala hukm që do të thotë *gjykim, vendim*.

Kuptimi i rregullës

Kjo rregull domethënë që *zakoni është ligj tek i cili duhet të kthehemi në disa çështje që nuk janë të përcaktuara nga ana e Sheriatit*.

Ligjvënësi i Urtë e ka paraparë zakonin që mbi të të bazohen dispozitat, pa marrë parasysh a janë dispozita të përgjithshme apo të veçanta, dhe e ka paraparë të jetë argument për të dispozituar atëherë kur nuk ka tekst dhe bazë në të cilën bazohen njerëzit në shpërndarjen e të drejtave dhe detyrave të tyre ndërmjet tyre kur ndërveprojnë në mes vete.

Pjesa e rregullit “fuqiplotë” e ka paraparë që ligji të jetë bazë ligjore dhe e ka bërë zakonin që të jetë mbështetje ligjore.

Ky rregull sqaron vendin (rolin) e zakonit dhe të marrurit si bazë ligjore në sheriatin islam.

Në këtë rregull, zakoni ngërthen në vete zakonin me llojet e tij siç janë: Zakoni shprehimor dhe zakoni veprues.

Shembuj:

- Zakoni është kriter për të vlerësuar një gjë si diçka e shpeshtë dhe e shumtë si f.v., namazi prishet nëse në të bëhen lëvizje të njëpasnjëshme, të cilat konsiderohen lëvizje të shpeshta ose të shumta sipas zakonit.

Dallimi më i njohur që është përmendur në përdorimin e këtyre fjalëve:

Një pjesë tjetër e dijetarëve anojnë kah ajo se këto fjalë dallojnë nga njëra-tjetra. Dallimi më i njohur që është përmendur në përdorimin e këtyre fjalëve është:

Fjala ‘adeh përdoret shpesh për gjërat që përsëriten tek individët, siç thuhet për të përmuajshmet “adetu el-mer’eti” (përsëritja e menstruacionit në mënyrë të vazhdueshme pas çdo muaji).

Fjala ‘urf përdoret për gjërat që janë të përsëritshme dhe që janë bërë të njohura në mesin e shoqërive.

Çdo traditë është zakon dhe çdo zakon nuk është traditë.

Sido që të jetë, kjo është çështje e thjeshtë, posaçërisht kur dihet kuptimi i një termi të caktuar, ngaqë nuk bëhet diskutim i ashpër në çështjet që kanë të bëjnë me termat.

Shembuj:

- Në qoftë se dy persona lidhin kontratë shitblerjeje duke mos e përcaktuar llojin e monedhës, e më pas bien në kundërshtim përkitazi me këtë, duhet shikuar lloji i monedhës që përdoret zakonisht në vendin ku është bërë kontrata.

- Në qoftë se dy persona lidhin kontratë shitblerjeje duke mos e përcaktuar llojin e valutës, e më pas bien në kundërshtim përkitazi me këtë, duhet shikuar lloji i valutës që përdoret zakonisht në vendin ku është bërë kontrata.

Argument

Thënia e Allahut: **“Gratë kanë aq të drejta sa kanë edhe detyra, sipas arsyes së shëndoshë (sipas zakonit të shëndoshë).”** (El-Bekare: 228)

Argument

Hadithi që e përcjell Aishja, Allahu qoftë i kënaqur me të, e cila thotë se Hindi, e bija e Utbes i kishte thënë të Dërguarit të Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të: “Ebu Sufjani është njeri koprrac, nuk më jep pasuri të mjaftueshme as për mua as për fëmijën tim, kështu që unë i marr pasuri pa qenë ai në dijeni. I Dërguari i Allahut, paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të, i tha: **“Merr (nga pasuria e tij) aq sa të mjafton ty dhe fëmijës tënd zakonisht.”**

Fushat në të cilat gjykohet sipas zakonit

Fushat në të cilat gjykohet sipas zakonit janë të shumta. Ndër to janë:

Fusha e parë:

Kur përmendet një term i përgjithshëm, i papërcaktuar në argumentet e Sheriatit. Pra, fetarisht nuk është i përcaktuar, siç është namazi, e as gjuhësisht, siç është vjedhja. Termat e tillë përcaktohen në bazë të zakonit të shëndoshë, fjala vjen, masa e shpenzimit për gruan dhe gjërat që llogariten bamirësi ndaj prindërve.

Fusha e dytë:

Shpjegimi i termave që i përdorin njerëzit në marrëveshjet (kontratat) dhe betimet e tyre, siç është,

- kush betohet se nuk do të hajë mish, nuk detyrohet të shpaguejë në qoftë se ha mish peshku. Tek arabët nuk është zakon që mishi i peshkut të quhet “mish”.

EL MEARUF URFEN KEL MESHRUTU SHARTEN

2. E përdorura në traditë është sikurse e kushtëzuara me kusht.

Kuptimi i këtij rregulli

Ajo çka vendoset nëpërmjet rrugës së traditës është sikurse e kushtëzuara me ndonjë kusht dhe përfshinë gjithë njerëzimin. Ai i cili ka mosmarrëveshje me kontraktuesin tjetër për mënyrën e shfrytëzimit të sendeve me qira apo të huazuara, zgjidhja në mes tyre bëhet në bazë si e parashihet qëllimin e shfrytëzimit tradita praktike.

Shembuj:

- Në qoftë se dikush e huazon veturën nga shoku i vet, nuk ka të drejtë të udhëtojë jashtë vendit me atë veturë, sepse kjo vetëkuptohet nga zakoni, prandaj është sikur të ishte kusht, përveç nëse shoku i tij pohon se ia lejon një gjë të tillë.

- Nëse ndokush e autorizon ndonjë person për t'i blerë veturë ose orëndi shtëpiake, këtij të fundit nuk i lejohet t'ia blejë ato me të meta, sepse të qenët pa të meta është sikur të ishte kusht, ngaqë vetë autorizimi e kërkon një gjë të tillë.

- Në qoftë se dy persona lidhin kontratë shitblerjeje duke mos e përcaktuar llojin e monedhës, e më pas bien në kundërshtim përkitazi me këtë, duhet shikuar lloji i monedhës që përdoret zakonisht në vendin ku është bërë kontrata.

EL MEARUUF BEJNEL TUXHAAR KEL MESHRUUT BEJNEHUM

3. Ajo që është e njohur në mesin e tregtarëve është si të ishte kusht në mesin e tyre.

Shembuj:

- Në qoftë se në mesin e tregtarëve që merren me prona dhe pasuri të patundshme në një vend të caktuar bëhet e njohur se shërbimet e zyrës së patundshmërive duhet t'i paguajë blerësi ose qiramarrësi, atëherë kjo gjë bëhet e detyrueshme për të, përveç nëse merren vesh ndryshe.

- Nëse në mesin e tregtarëve bëhet e njohur se transportimi i gjësendeve të blera deri në veturën ose në shtëpinë e klientit hyn në kontratë, atëherë shitësi detyrohet të bëjë një gjë të tillë pa pagesë, përveç nëse merren vesh ndryshe.

ETTEAJIIN BIL URFI KET TEAJIIN BIN NASI

4. Ajo që është caktuar në bazë të zakonit është sikur të ishte e caktuar me tekst.

Shembuj:

- Në qoftë se dikush merr me qira një shtëpi në një lagje banimi, atë duhet ta shfrytëzojë vetëm për banim, e nuk i lejohet ta përdorë si magazinë për ruajtjen e mallit pa lejen e pronarit të shtëpisë.

- Në qoftë se dikush merr me qira një shtëpi në një lagje banimi, atë duhet ta shfrytëzojë vetëm për banim, e nuk i lejohet ta shndërrojë në dyqan pa lejen e pronarit të shtëpisë.

- Nëse dikush merr një veturë me qira për ta shfrytëzuar në mënyrë të zakonshme, atij nuk i lejohet të bartë me të gjëra që nuk është e zakonshme të barten me të, fjala vjen, të bartë me të shtazë.

- Nëse dikush merr një veturë me qira për ta shfrytëzuar në mënyrë të zakonshme, atij nuk i lejohet të bartë me të gjëra që nuk është e zakonshme të barten me të, fjala vjen, të bartë me të drunj, e të ngjashme.

LAA JUNKER TEG'JIIRIL AHKAAM BI TEG'JIIRIL EZMAAN

5. Nuk mohohet ndryshimi i dispozitave në bazë të ndryshimit të kohëve.

Kuptimi i rregullit

Dispozitat e ndërtuara nga tradita ndryshojnë me ndryshimin e traditës mbi të cilën është ndërtuar sepse dispozita sillet me arsyen, kur mungon arsyeja mungon dispozita dhe anasjelltas, kur ekziston arsyeja ekziston edhe dispozita.

Në Kur'an dhe sunet kemi tekste të papërcaktuara e që njeriu duhet t'i përcaktojë. E njeriu i përcakton varësisht prej traditës dhe zakonit. Kjo është mëshirë dhe tolerancë për veprimtarinë në mes njerëzve, për të mirën e tyre, ashtu që ligjet e sheriatit të jenë të përshtatshme për çdo vend dhe për çdo kohë.

Tradita është dy llojesh:

- Tradita e pandryshueshme,
- tradita e ndryshueshme.

Tradita e pandryshueshme

Tradita e pandryshuar e cila nuk ndryshon prej një vendi në vend tjetër, është traditë e cila buron nga ndryshueshmëria e njeriut të cilën e kërkon ndjenja njerëzore, si f.v., tradita për ushqim, fjetje, etj.

Tradita e ndryshueshme

- Tradita e ndryshueshme është tradita e cila ndryshon me ndryshimin e kohëve dhe vendeve.



Për këtë arsye në kohën e imam Ebu Hanifes ngjyra e zezë është llogaritur se është “Turp” nga shkaku se uzurpatori identifikohet me këtë ngjyrë, sepse uzurpatori e ngjyrote rrobën me ngjyrë të zezë dhe e njolloste të bardhën, pas kësaj, kur ka ndryshuar tradita e njerëzve dhe ngjyra e zezë nuk e identifikonte uzurpatorin (kriminelin) dhe nuk ishte ngjyra e tij si ngjyrë identifikimi apo si ngjyrë bazike, por ishte vetëm si ngjyrë e cila nuk identifikonte asgjë por ishte si ngjyrë shtesë, dhe jo ngjyrë bazike (identifikuese), atëherë edhe dy studentët e tij e kanë llogaritur ngjyrë shtesë dhe jo ngjyrë bazike, jo ngjyrë identifikuese e uzurpatorit (kriminelit).

Nëse bëhet traditë që të paguhet mehri para kontaktit dhe pastaj ndryshon tradita e cila lejon që një pjesë e mehrit të jetë i menjëhershëm dhe një pjesë tjetër pas një afatizimi, atëherë veprohet me traditën e re dhe anashkalohet tradita e menjëhershme.

KAPITULLI I PESTË

Në këtë kapitull i kemi paraparë katër rregulla e ato janë:

1. Pastërtia është gjysma e besimit.
2. Uji është i pastër përderisa nuk e humb ngjyrën, shijen apo erën.
3. Kur të prezanton uji, prishet Tejemumi.
4. Besimtari mbetet i pastër.

ET- TAHURU NISFUL IIMAAN

1. Pastërtia është gjysma e besimit.

Shpjegimi i termave

Në etimologji fjala **Et-Tahare** do të thotë: *pastrim, mënjanim nga ndyrësitat lëndore materiale që shihen me anë të syrit.*

Po ashtu në etimologji fjala **Et-Tahare** e ka kuptimin edhe *pastrim shpirtëror*, siç është pastrimi nga mëkatet.

Në terminologji fjala **Et- Tahare** do të thotë: *Veprim (pastrim) me të cilin lejohet falja e namazit*, duke filluar nga abdesi, pastërtia e trupit e deri te tejmemi, që synon largimin e papastërtisë materiale dhe asaj ligjore.

Zoti i Lartmadhëruar thotë: **“Aty ka burra që dëshirojnë të pastrohen mirë, e Allahu i do të pastrit.”** (Teuvbe : 108)

Fjala **Imanë** do të thotë *të besuarit çdo gjë që i ka zbritur peygamberit s.a.v.s. nga Zoti.*

Besimi duhet të jetë:

- Me zemër,
- me gjuhë,
- me të vepruarit në atë çka ka urdhëruar Zoti për të vepruar, dhe
- me të larguarit nga ajo çka e ka ndaluar Zoti për të vepruar.

Rregulli fikhor: “Pastërtia është gjysma e besimit (imanit)” është rregull e përgjithshme dhe në kuptim gjithëpërfshirës përfshinë:

- pastërtinë konkrete dhe
- pastërtinë abstrakte.

Kjo, pasi që besimi nënkupton bindje dhe veprim.

Çka përfshinë kjo rregull?

Është rregull e përgjithshme dhe përfshinë:

- Çështjet e besimit;
- Çështjet e adhurimit;
- Çështjet e raporteve ndërnjerëzore.

Duhet ditur se:

- Pastërtia është kusht për vlefshmërinë e namazit.
- Pastërtia është kusht për vlefshmërinë e tavafit.
- Pastërtia është kusht për leximin e Kur'anit.
- Pastërtia është kusht për agjërim, kjo sa i përket femrës që është në kohën e menstruacionit dhe të lehonisë.
- Pastërtia është kusht për faljen e namazit, kjo sa i përket femrës që është në kohën e menstruacionit dhe të lehonisë.

Në shumë veprime ndërnjerëzore pastërtia është kusht si p.sh.:

- Nuk lejohet shitblerja e sendeve të papastra.
- Nuk lejohet dhurimi i sendeve të papastra.
- Nuk lejohet lëmosha e sendeve të papastra.
- Nuk lejohet shfrytëzimi i sendeve të papastra.

Urtësia e pastërtisë

Urtësia e pastërtisë dhe dobisë e saj janë të shumta dhe të natyrave të ndryshme.

Njeriu tenton dhe ka për obligim islam dhe moral që të ruajë pastërtinë e tij shpirtërore.

Kur njeriu dëshiron të kryejë obligime islame siç është namazi, ai dëshiron që para Zotit të tij të dalë jo vetëm me zemër dhe me shpirt të pastër, por edhe me trup dhe me rroba të pastra.

Pastrimi i shpirtit

Të gjitha adhurimet kanë një qëllim, që është pastrimi i shpirtit. Allahu i Lartësuar thotë:

“Vërtet, kushdo që e pastron shpirtin, do të shpëtojë.”

“Merr nga pasuria e tyre lëmoshë, me të cilën t’i pastrosh ata dhe t’ua rrisësh veprat e mira”.

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Me të vërtetë, Allahu nuk shikon fizionominë tuaj, por shikon brenda zemrave tuaja.”

Prandaj, pastërtia e shpirtit konsiderohet sa gjysma e besimit.

- Sa i përket **Besimit**, vendi i besimit është zemra, andaj zemra duhet të pastrohet prej:

- urrejtjes;
- kryelartësisë;
- mashtrimit;
- lakmisë;
- proklamimit;

- Kemi pastërti të zemrës e cila paraqet nivelin më të lartë të besimit, dhe

- kemi pastërti fizike e cila paraqet veprimin e veprave të larta dhe fisnike.

Që të dy llojet bëjnë pjesë në pastërti abstrakte.

Përveç pastërtisë abstrakte e kemi edhe pastërtinë konkrete, e këtu hyjnë pastërtia nga ndyrësitat dha pjesëve neveritëse siç janë:

- Shkurtimi i thonjve;
- shkurtimi i qimeve nënsqetulla;
- shkurtimi i qimeve nga organet e turpshme.

Pastërtia është term gjithëpërfshirës në të gjitha elementet, përndryshe nuk do të ishte llogaritur si “gjysma e besimit”.

EL MAU TAHURUN IL- LA MA GALEBE TAMUHUU EV RIJHUHU EVLEVNUHU

2. Uji është i pastër përderisa nuk e humb ngjyrën, shijen apo erën.

Kjo është një shprehje e njohur në mesin e Fukahave.

Dijetarët gjykojnë se uji është i papastër nëse uji e ndryshon një cilësi prej tri cilësive, për shkak të përzierjes me ndonjë element të prishur:

- Nëse uji ndryshon shijen, uji është i papastër.
- Nëse uji ndryshon erën, uji është i papastër.
- Nëse uji ndryshon ngjyrën, uji është i papastër.

Ka dallim në mes të ujit të pastër dhe ujit pastrues:

- **Uji i pastër** është uji i cili është i pastër në vetvete, por nuk e pastron tjetrin.
- Uji i pastër pastrues është uji i cili është i pastër në vetvete dhe e pastron tjetrin.

Kjo do të thotë se çdo ujë pastrues është i pastër, por çdo ujë i pastër nuk është pastrues.

- Për këtë kriter janë të pajtuar të gjithë dijetarët.

3. Kur të prezanton uji, prishet Tejemumi.

Shpjegimi i rregullës

Kush merr Tejemum për të zëvendësuar abdesin për shkak të mungesës së ujit, pastaj ai gjen ujë (ose furnizohet me ujë) nuk falet me atë Tejemum, por e ka obligim që të merr abdes, e pastaj e falë namazin.

Kush merr Tejemum për të zëvendësuar gusulin për shkak të mungesës së ujit, pastaj ai gjen ujë (ose furnizohet me ujë), në këtë moment i zhvlerësohet Tejemumi dhe e ka obligim që të merr gusul, e pastaj e falë namazin dhe vazhdon me kryerjen e detyrave si i pastër.

Për zhvleftësimin e Tejemumit kur të bëhet furnizimi me ujë i kemi tri raste:

Rasti i parë:

- Nëse një person merr Tejemum për shkak se nuk ka ujë, pastaj gjen ujë, apo furnizohet me ujë, ai nuk ka të drejtë të falet me atë tejemum por duhet që të merr abdes.

Rasti i dytë:

- Nëse një person merr Tejemum dhe është në namaz dhe brenda namazit e kupton se ka ujë në prezencën e tij, ai nuk e ndërprejnë për shkak të rëndësisë dhe vlerës së namazit, por e përfundon dhe e përsëritë namazin.

Rasti i tretë:

- Nëse një person merr Tejemum, e falë namazin, e përfundon namazin duke dhënë salam dhe pastaj gjen ujë, ai nuk e përsëritë namazin, por nëse e përsëritë është për t'u lavdëruar, por nuk është i obliguar.

Ky kriter është i njohur në thëniet e fukahave, deri sa është bërë shembull dhe është përdorur vazhdimisht si rregull.

EL MUËMINU LA JUNGJES

4. Besimtari mbetet i pastër.

Bazë e këtij rregulli është hadithi i Muhamedit a.s.:

Transmeton Ebu Hurejre r.a. se ai e kishte takuar peygamberin s.a.v.s. në një rrugë prej rrugëve të Medinës përderisa ai ishte xhunub (i papastër), andaj largohet nga peygamberi s.a.v.s. dhe shkon e pastrohet (merr gusul) dhe kthehet prapë te peygamberi s.a.v.s.

Peygamberi s.a.v.s. e pyet: - Ku shkove o Ebu Hurejre?

- Isha i papastër (xhunub) dhe nuk dëshiroja të qëndroja me ty i papastër - i thotë Ebu Hurejre.

Atëherë peygamberi i thotë: - Besimtari është i pastër dhe nuk mund të jetë i papastër.

Thënia: “**Besimtari nuk është i papastër.**” ka kuptimin se *besimtari në esencë është i pastër*, por kjo nuk do të thotë se besimtarin nuk mund ta përfshijë papastërtia fizike.

Këtu kemi të bëjmë me pastërtinë juridike e cila vlen për jetën e rëndomtë, për të ushqyerit, veshmbathjen, të ecurit, etj.

KAPITULLI I GJASHTË

Në këtë kapitull i kemi paraparë katërmëdhjetë rregulla e ato janë:

1. Çdo risi është bid'at.
2. Argumentimi për akuzuesin (pretenduesin), përbetimi për të akuzuarin (mohuesin).
3. Padituria, harresa dhe pavetëdija edhe pse nuk konsiderohen mëkat, gjykim merret për ta.
4. Pajtimi është i lejuar, pos pajtimit i cili e lejon ndaluarën apo e ndalon të lejuarën.
5. Përfitimi shkon proporcionalisht me dëmtimin.
6. Kush përshpejton një të drejtë ligjore (me pa të drejtë) dënohet me ndalim të asaj të drejte.
7. Çdo kusht i cili nuk është në librin e Allahut është i pavlefshëm.
8. Trashëgimtari nuk ka të drejtë testamenti.
9. Zekati nuk lejohet për lozën e poshtme dhe lozën e epërme.
10. Kush krediton, le të kreditojë me sasi të caktuar në masë të caktuar dhe në afat të caktuar.
11. Mbështetësi në Çështje është edhe vetë çështja.
12. Mashtruesi është ngrënës i kamatës.
13. Angazhimi dhe veprimi i shumtë ka vlerë më të madhe.
14. Shorti hidhet kur të drejtat janë të barabarta.

KUL-LU MUHDETHIN BIDATUN

1. Çdo risi është bid'at.

Edhe pse dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme rreth terminologjisë së bid'atit, në përgjithësi bid'ati determinohet si veprim i cili nuk është vepruar në kohën e pejgamberit s.a.v.s. Po ashtu, **bid'ati** mund të formulohet edhe kështu: *çdo veprim, ngjarje, ndodhi apo shprehi e cila nuk është në Kur'an, sunet dhe ixhmaë.*

Mendimet e dijetarëve rreth asaj se çka konsiderohet bid'at sillen rreth këtyre çështjeve:

- A konsiderohet bid'at çdo ngjarje, ndodhi apo shprehi e cila nuk është në Kur'an, sunet dhe ixhmaë, pa marrë parasysh a ka të bëjë edhe me adhurime dhe traditë?

- A konsiderohet bid'at çdo ngjarje, ndodhi apo shprehi e cila nuk është në Kur'an, sunet dhe ixhmaë, vetëm në adhurime dhe jo në traditë? Me fjalë tjera, sipas kësaj, veprimi konsiderohet bid'at vetëm kur është e natyrës së adhurimit (ibadat).

- A konsiderohet bid'at çdo ngjarje, ndodhi apo shprehi e cila nuk është në Kur'an, sunet dhe ixhmaë, pa marrë parasysh a është veprim i lavdëruar apo i përbuzur?

Bid'ati i përbuzur dhe bid'ati i lavdëruar

A konsiderohet bid'at çdo ngjarje, ndodhi apo shprehi e cila nuk është në Kur'an, sunet dhe ixhmaë, pa marrë parasysh a është veprim i lavdëruar apo i përbuzur?

Ata të cilët nuk e pranojnë bid'atin (e lavdëruar) argumentohen me ajetin kur'anor:

“Sot e kam përsosur për ju fenë tuaj dhe në të i kam përmbledhë dhe plotësuar begatitë e mia dhe jam i kënaqur që ju tani fe e keni islam.” (Suretul Maide : 3).

Po ashtu thënie e Muhamedit a.s.: **“... çdo shpikje është bid'at, çdo bid'at është devijim dhe çdo devijim shpie në zjarr.”**

Mirëpo pjesa e hadithit: **“Çdo shpikje është bid’at”**, ka për qëllim çdo veprim dhe praktikë e cila është në kundërshtim me bazat e sheriatit dhe e cila nuk është në përputhshmëri me sunetin e Muhamedit a.s.

Po ashtu janë argumentuar edhe me hadithin tjetër të Muhamedit a.s.: **“Ai që shpik në këtë fe diçka që s’është pjesë e saj, do të jenë të refuzuar.”**

E vërteta është se ky hadithë nuk tregon se çdo bidat është devijim në të gjitha veprimet dhe aktivitetet sepse bid’ati ndonjëherë është i lavdëruar, e ndonjëherë është i përbuzur, kur dihet se në një hadithë Muhamedi a.s. ka thënë:

“Kush vendos një praktikë të mirë, do të ketë shpërblim për të çdo herë që e vepron ndokush atë praktikë gjatë jetës së tij dhe pas vdekjes derisa të mos punohet ai veprim, dhe kush e vendos një praktikë të keqe do të bart mëkatin e saj, derisa të mos veprohet ai veprim.”

Thënia e Muhamedit a.s. **“një praktikë e mirë”** d.m.th. një rrugë e pranuar të cilën e ndjekin njerëzit.

Hadithi tregon se ka veprime, praktika dhe veprime të mira ashtu siç ka veprime dhe praktika të këqija.

Dallimi në mes të veprës së mirë dhe të keqe varet prej asaj se ai veprim a përputhet apo nuk përputhet me bazat e sheriatit, pra kandari i vërtetë i përcaktimit të bidatit në të lavdëruar apo të përbuzur është sheriatit.

Bid’at i mirë (i lavdëruar) – është ajo që është në harmoni me bazat e sheriatit, edhe nëse kjo është një çështje e re e cila është brenda rregullave të sheriatit dhe kuptimit të përgjithshëm të ajeteve dhe haditheve. Për këtë arsye, ajo vepër quhet e mirë dhe ka shpërblim dhe shpërblimi vazhdon edhe pas vdekjes.

Bidat i keq (i përbuzur) – është ai veprim apo ajo praktikë e cila është në kundërshtim me rregullat e sheriatit, pra veprimet dhe praktikat e këtij lloji janë bid’at i përbuzur dhe i devijuar.

Dallimi ndërmjet bid'atit të mirë dhe bid'atit të keq:

- ajo që nuk është pjesë e fesë dhe që është në kundërshtim me rregullat e sheriatit, ai veprim dhe ajo praktikë konsiderohet e refuzuar dhe e devijuar;

- ajo që është pjesë e fesë dhe ka mbështetje në parimet e fesë është e pranueshme dhe është një veprim dhe praktikë e mirë.

- ajo që përputhet me Kur'anin dhe me sunetin është e lavdëruar.

- ajo çka është në kundërshtim me atë që ka urdhëruar Allahu dhe i dërguari i Tij, ai veprim dhe ajo praktikë llogaritet bid'at i përbuzur.

- ajo çka është brenda kornizës të cilën Allahu e ka konsideruar të pëlqyer dhe ku Allahu dhe i dërguari i Tij kanë nxitur drejt saj, atëherë ai veprim apo ajo praktikë bën pjesë brenda kornizës së lavdërimit.

- ajo çka është në kundërshtim me atë që ka urdhëruar Allahu dhe i dërguari i Tij. Ai veprim apo ajo praktikë llogaritet bid'at i përbuzur.

Bid'ati ndahet në:

- bid'at vaxhib (obligativ);

- bid'at haram (të ndaluar);

- bid'at mendub (i pëlqyer);

- bid'at mekruh (i urryer);

- bid'at mubah (i lejuar).

Bidati vaxhib – mësimi, aktiviteti gramatikor i gjuhës arabe, pa të cilin aktivitet nuk mund të kuptohet fjala e Allahut dhe të dërguarit të tij.

Pse është vaxhib (obligativ) bid’ati i të mësuarit të gramatikës së gjuhës arabe?

Përgjigja: Për t’u ruajtur dhe për t’u siguruar sheriat, është i patjetërsueshëm mësimi i gjuhës arabe. Përveç kësaj, rregull e fikhut është: **Veprimi me të cilin plotësohet obligimi është obligim.**

Umer ibn Hattabi r.a. ka thënë: **“Mësojeni gjuhën arabe se mësimi i saj e zhvillon mendjen dhe moralin.”**

Bid’ati haram – është haram të debatohet për çështjen e kaderit. Ky është debat i cili shkakton dhënie të mendimit pa njohuri sepse kaderi i Zotit është çështje e panjohur për njeriun.

Bid’ati mendub – prej bid’atit të pëlqyer është themelimi i institucioneve arsimore në të gjitha nivelet arsimore.

Bid’at i pëlqyer – është edhe falja e namazit të teravive në xhami me imam (me xhemat). Kur Umeri r.a. i ka parë sehabet të bashkuar për namaz të teravive në ramazan në xhami pas një imami, ka thënë: **“Sa i mirë është ky bid’at!”**

Bid’ati mekruh – zbukurimi i tepërt i xhamive.

Bid’ati i lejuar – është llojllojshmëria me ushqime, në veshmbathje, etj.

EL BEJJINETU ALAA MENID-DEAA VEL JEMIINU ALAA MEN ENKERE

2. Argumentimi për akuzuesin (pretenduesin), përbetimi për të akuzuarin (mohuesin).

Ky rregull përbëhet prej dy çështjeve dhe dy palëve:

Dy çështjet janë:

1. Argumentimi dhe
2. përbetimi.

Dy palët janë:

1. Akuzuesi dhe
2. i akuzuari

1. Argumentimi (El-Bejjinetu)

Argumentimi në ligj është emër i cili sqaron të vërtetën.

Argumentimi duhet të bëhet:

- ndonjëherë me 4 dëshmitarë, si f.v. kur është në pyetje për prostitucion.
- ndonjëherë me 2 dëshmitarë, si f.v.: në kurorëzime, shkukurëzime dhe në dënimet tjera strikte.
- ndonjëherë me 1 dëshmitar, si f.v.: një mjek musliman.
- ndonjëherë me 1 dëshmitare, si f.v.: gruaja në rastin e gjdhënies, e të ngjashme ku mund të jetë dëshmitare femra.

2. Përbetimi (El-Jemiinu)

Përbetim quhet të betuarit vetëm në Allahun xh.sh. ose në cilësitë (emrat e bukur të Tij) e Tij, kur është në pyetje vërtetimi i një të drejte apo mospranimi i një padrejtësie.

Përbetimi konsiderohet argument vetëm për të mos pranuar akuzën (fajin).

Argumenti, pra është dëshmia dhe faktet të cilat sqarojnë të vërtetën dhe realitetin. Ndërsa përbetimi konsiderohet argument vetëm për të mos pranuar akuzën (fajin).

Ligji nuk i konsideron të pavlefshme faktet, shenjat, gjurmët dhe rrethanat.

Argumenti i kësaj rregulle

Argument i kësaj rregulle është hadithi i Muhamedit a.s. ku thotë: **“Argumentimi për akuzuesin, përbetimi për të akuzuarin.”**

Kjo rregull bazohet në rregullën bazë të saj **“prezumimi i pafajësisë”**, që do të thotë se ***i akuzuari llogaritet i pafajshëm përderisa akuzuesi nuk paraqet fakte dhe dëshmi.***

Urtësia e rregullit

- Ana e akuzuesit është e dobët.
- Ana e të akuzuarit është e fortë.

Ana e akuzuesit është e dobët nga shkakut se ai pretendon të kundërtën e çështjes së dukshme dhe të prekshme. Fakti dhe dëshmia janë obligative për të forcuar anën e tij, ai anën e dobët e forcon me fakt, dëshmi dhe me argument.

EL XHEHLU VEN- NISJAN VEL HATAË JERFEUL ITHMU VE LAJ JESKUTUL HUKMU

3. Padituria, harresa dhe pavetëdija edhe pse nuk konsiderohen mëkat, gjykim merret për ta.

Kjo rregull fikhere është e përgjithshme në të gjitha veprimet.

Arsyetimet e të ngarkuarit janë tri llojesh:

1. Padituria, harresa dhe pavetëdija, në mosveprimin e urdhëresave.
2. Padituria, harresa dhe pavetëdija, në të vepruarit e ndalesave.
3. Padituria, harresa dhe pavetëdija, në rastet kur vepron të ndaluarën, apo nuk e kryen obligimin i cili rezulton ndëshkimin.

1. Padituria, harresa dhe pavetëdija, në mosveprimin e urdhëresave.

Në këtë rast i falet gabimi, por ligji mbetet në fuqi, dhe:

- i padituri e ka obligim që kur ta kuptojë, ta kryej obligimin;
- harrestari e ka obligim që kur t'i kujtohet ta kryej obligimin,
- i pavetëdijshmi i cili ka bërë gabim e përmirëson kur të vetëdijesohet.

Shembuj:

- Kush harron agjërimin, e të ngjashme, ai e ka obligim ta bëj KADA (Kaza).
- Kush harron namazin, e të ngjashme, ai e ka obligim ta bëj KADA (Kaza).
- Kush harron zekatin, e të ngjashme, ai e ka obligim ta bëj KADA (Kaza).
- Kush harron haxhin, e të ngjashme, ai e ka obligim ta bëj KADA (Kaza).
- Kush shet një kg me dy kg (të të njëjtit artikull) të njëjtë nga mosdija dhe e kupton me vonesë se është kamatë, atëherë akti anulohet.

2. Padituria, harresa dhe pavetëdija në të vepruarit e ndalesave, të cilat ndalesa dëmtojnë tjetrin.

Kush e vjedh një pjesë ushqimi dhe ia jep një personi dhe ai person e konsumon pa dijeni se është e vjedhur, e më vonë e kupton, dënohet konsumuesi. Ka mendime se dënohet vjedhësi.

3. Padituria, harresa dhe pavetëdija, në rastet kur vepron të ndaluarën, apo nuk e kryen obligimin i cili rezulton ndëshkimin.

- Kush pi alkool pa dijeni për ndëshkimin, nuk ndëshkohet.
- Kush kontakton me bashkëshorten gjatë ditës duke qenë agjërueshëm, pa dijeni se është e ndaluar, ai e përsërit agjërimin, por nuk ka kompensim (Kefaret) të dënimit të tij për të.

Bazë (argument) e kësaj rregulle është thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Nuk është ndonjë mëkat juaji ajo për çka keni gabuar (keni vepruar pavetëdije), por (është mëkat) ajo që zemrat tuaja e bëjnë qëllimisht, po All-llahu është që falë, është mëshirues.” (El-Ahzab : 5)

Ajeti në fjalë është i përgjithshëm dhe përfshin në vete çdo gabim pa vetëdije.

Bazë e harresës është edhe thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“Dhe fale namazin, në përkujtim për Mua.”

Kush e harron namazin dhe e falë kur t’i kujtohet, për të nuk ka mëkat.

Argument është hadithi i Muhamedit a.s.:

“Vërtet Allahu e ka zhvleftësuar mëkatën për umetin tim kur ata harrojnë, gabojnë apo janë të kërcënuar (detyruar).”

ES-SULHU XHAAIZUN BEJNEL MUSLIMIINE IL- LAI SULHAN HARREME HALAALEN EV EHAL-LE HARAAMEN

4. Pajtimi është i lejuar, pos pajtimit i cili e lejon ndaluarën apo e ndalon të lejuarën.

Pajtimi është akt i cili me kushte ligjore eliminon armiqësinë në mes të armiqësuarve.

Pajtimi është i ligjësuar:

- me Kur'an;
- me sunet;
- me ixhmaë.

Edhe argumentet logjike janë argument për pajtimin.

Argumentet nga Kur'ani

Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Nëse ndonjë grua i frikësohet largimit për shkak të ftohjes së burrit të vet ndaj asaj, atëherë nuk gabojnë poqëse bëjnë mes vete mbarim (pajtim). PAJTIMI është më i dobishmi.” (En-Nisa : 128)

Pastaj e kemi ajetin tjetër fisnik ku Zoti i Lartmadhëruar thotë:

“Nuk ka kurrfarë dobie në shumë biseda të tyre të fshehta, pos:

- kush këshillon për sadaka,
- për ndonjë të mirë ose
- PAJTIM mes njerëzve” (En-Nisa : 114)

Kemi edhe ajetin tjetër në Kur'anin Fisnik:

“Nëse dy grupe besimtarësh tentojnë të luftojnë ndërmjet vete, ju PAJTONI ata, e në qoftë se ndonjëri prej tyre e sulmon tjetrin, atëherë luftojeni atë grup që vërsulet me pa të drejtë, derisa t’i bindet udhëzimit të All-llahut, e nëse ktheheni, atëherë me drejtësi bëni PAJTIMIN ndërmjet tyre, mbajeni drejtësinë, se vërtet All-llahu i do të drejtë.” (El-Huxherat : 9)

Pastaj edhe ajetin tjetër:

“S’ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, pra bëni PAJTIM ndërmjet vëllezërve tuaj dhe kijeni frikë All-llahun, që të jeni të mëshiruar.” (El-Huxherat : 10)

Argument nga hadithi

Buhariu në sahihun e tij transmeton se Keab bin Maliku është konfrontuar me ibn Ebi Hududin për një borxh të cilin ia kishte dhënë. Pejgamberi s.a.v.s i pajtoi ata në atë mënyrë që ibn Keabi të hiqte dorë nga një pjesë e borxhit ndërsa ibn Ebi Hududin e urdhëroi që pjesën tjetër t’ia paguan.

Argument nga ixhmai

Janë pajtuar sehabet në lejin e pajtimit në përgjithësi edhe pse për disa forma të pajtimit nuk janë pajtuar.

Argumenti logjik

Logjika e pranon lejin e pajtimit në mes njerëzve sepse kjo e largon çrregullimin i cili veç ka ndodhur, ose e parandalon çrregullimin i cili mund të ndodhë sepse pajtimi ndalon acarimin e mëtutjeshëm, ndërsa acarimi është shkak i çrregullimit.

Pajtimi është shumëllojësh:

1. Pajtimi i lejuar;
2. Pajtimi i pëlqyer;
3. Pajtimi obligativ;
4. Pajtimi mekruh;
5. Pajtimi haram;

Pajtimi i lejuar është pajtimi i cili është në kënaqësinë e Allahut dhe në kënaqësinë e dy të ngatërruarve. Baza e këtij pajtimi është barazia dhe drejtësia. Zoti i Lartmadhërishëm thotë: **“Dhe PAJTONI në mes tyre dhe bëjeni me drejtësi.”**

Baza e pajtimit është lejimi i pajtimit në mes njerëzve.

Ka mendime se baza e pajtimit është mendub.

Llojet e të drejtave dhe pajtimit

Të drejtat për pajtim janë tri llojesh:

1. Të drejtat e njeriut ndaj Krijuesit;
2. Të drejtat e njeriut ndaj njeriut;
3. Të drejtat që ndërlidhen në mes njerëzve dhe Krijuesit.

1. Të drejtat e njeriut ndaj Krijuesit

Nuk lejohet pajtimi në një të drejtë prej të drejtave të Allahut.

Kjo është aprovuar nga ixhmai si f.v.:

- Nuk lejohet pajtimi për dënimin e prostitucionit.
- Nuk lejohet pajtimi për dënimin për vjedhje.
- Nuk lejohet pajtimi për dënimin e pirjes së alkoolit.

Shembull:

- Prostituti i cili ka bërë prostitucion thotë: Merreni këtë pasuri që të mos ngrihet padia në prokurori, e kjo nuk lejohet nga shkaku se e drejta e Allahut është e prerë dhe absolute, andaj nuk ka amnisti.

- Hajni i cili ka vjedhur të thotë: Merreni këtë pasuri që të mos ngrihet padia në prokurori. Kjo nuk lejohet nga shkaku se e drejta e Allahut nuk lejon amnisti.

Në raste të ngjashme, as gjykata as prokuroria, as qeveritari, nuk e kanë të drejtën e faljes apo të amnistisë.

Kjo është e njohur me Kur'an dhe me Sunetin e Muhamedit a.s.

2. Të drejtat e njeriut ndaj njeriut

Pajtimi të cilin e parasheh ligji islam ka të bëjë me të drejtën e njeriut, nga shkaku se pajtimi është i ndërlidhur me të drejtën e njerëzve:

- ose faljen në tërësi;
- ose faljen e një pjese të fajit;
- ose faljen me kompensim.

3. Të drejtat që ndërlidhen në mes njerëzve dhe Krijuesit

- Nëse është e drejta e Allahut me të drejtën e robit, nuk lejohet falja apo amnistia, sepse dominon e drejta e Allahut ndaj të drejtës së njeriut si f.v.: shpifja për prostitucion:

Në shpifjen për prostitucion kemi dy të drejta:

- e drejta e Allahut,
- e drejta e njeriut.

Për shpifje për prostitucion dominon e drejta e Krijuesit ndaj të drejtës së njerëzve.

Në këtë çështje nuk lejohet pajtimi, as amnistia, por vetëm realizohet dënimi për shpifje.

EL-GUNMU VEL GURMU

5. Përfitimi shkon proporcionalisht me dëmtimin.

Ky rregull përbëhet prej dy fjalëve:

Fjala **Gurmu** nënkupton *një lloj dëmi apo humbje e cila shkaktohet te ai i cili ka të drejtë të shfrytëzojë në diçka.*

Fjala **Gunmu** nënkupton *shfrytëzim dhe përfitim i cili realizohet, ose nëpërmjet të drejtës pronësore, të qirasë apo të vepruarit në diçka.*

Kuptimi i rregullës

Ai i cili realizon përfitim diçka prej një Çështjeje duhet të bartë përgjegjësinë e dëmit të shkaktuar gjatë përfitimit varësisht sa ka shfrytëzuar apo sa ka përfituar.

Shembuj:

- Nëse dy bashkëpronarë dëshirojnë të riparojnë apo të rindërtojnë diçka, atëherë secili duhet të paguajë varësisht sa ka të drejtë dhe sa shfrytëzon.

- Nëse dy bashkëpronarë kanë një pronë, atëherë secili prej tyre sa e shfrytëzon atë pronë e bartë përgjegjësinë e humbjes ashtu siç e ka edhe të drejtën e përfitimit prej asaj prone.

MEN ISTEAXHELE SHEJ'UN KABLE EVAANIHI UUKIBE BI HURMAANIHI

6. Kush përshpejton një të drejtë ligjore (me pa të drejtë) dënohet me ndalim të asaj të drejte.

Ky rregull ndërtohet mbi bazën e masave parandaluese.

Kuptimi i rregullës

Ai cili e përshpejton një çështje, të cilën çështje ia parasheh ligji në kohë të caktuar, atëherë ai ndëshkohet në përfitimin prej asaj çështjeje të cilën e ka përshpejtuar padrejtësisht, sepse ai e ka dhunuar ligjin me përshpejtimin me pa të drejtë.

Disa raste të cilat rezultojnë nga ky rregull

- Privohet vrasësi i cili e vret trashëgimtarin për të përshpejtuar pjesën e trashëgimisë së tij.
- Privohet vrasësi i cili e vret testamentlënësin e tij, për ta përshpejtuar testamentin e tij.
- Kush e shkurorëzon gruan përderisa ai është në shtratin e vdekjes, pa dëshirën e saj, për ta penguar nga trashëgimia, dhe vdes para se t'i kaloj IDETI, gruaja e tij trashëgon.

Urtësia e rregullit

Sigurimi dhe garantimi i të drejtave njerëzore.

Përrjashtim nga rregulla fikhere

- Nëse borxhthënësi e vret borxhmarrësin, pasardhësit e kryejnë borxhin nga pasuria e borxhmarrësit. Në këtë rast ligji ka bërë përrjashtim.

- Nëse një grua përdorë medikamente medicinale për t'i ardhur menstruacionet, ajo (pasi që i vijnë menstruacion, nuk falet) nuk i fal namazet Kaza, sepse mosfalja e namazeve Kaza është i ndërlidhur me menstruacionin, pa marrë parasysht a e përrshpejton apo jo.

- Nëse një person përdorë medikamente medicinale për t'u sëmurë që pastaj të lirohet nga agjërimi, nuk dënohet me agjërim, pra duke e urdhëruar për të agjëruar sepse masa lehtësuese e agjërimit ndërlidhet me sëmundjen, dhe tani më ai është i sëmurë dhe nuk merret parasysht qëllimi i tij, sepse është çështje e dyshimit.

KUL-LU SHARTIN LEJSE FI KITABIL-LAAHI FE HUVE BATIL

7. Çdo kusht i cili nuk është në librin e Allahut është i pavlefshëm.

Kjo rregull tregon për mënyrën se si duhet të bashkëveprojnë njerëzit në mes vete sepse përkufizon të drejtën e secilit kur të kontraktin diçka, qoftë në mes të individëve, qoftë në mes shoqërive.

Argument

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Çdo kusht i cili nuk është në librin e Allahut është i papranueshëm dhe i pavlefshëm, qofshin edhe njëqind kushte”.

Nga hadithi kuptohet se një akt nuk është i vlefshëm, edhe poqëse në atë akt parashihen njëqind kushte nëse ato kushte janë në kundërshtim me librin e Allahut.

Kushtet janë shumëllojesh:

- Kushtet të cilat patjetër duhet plotësuar (zbatuar).
- Kushtet të cilat është mirë të zbatohen.

Kushtet të cilat patjetër duhet zbatuar:

Janë kushtet të cilat Allahu xh.sh. i ka urdhëruar në librin e tij fisnik dhe kushtet të cilat i shohim në sunetet e pejgamberit s.a.v.s.

- Për këtë janë pajtuar të gjithë dijetarët.

Kushtet të cilat nuk duhet zbatuar:

- Kushtet të cilat nuk duhet zbatuar dhe nuk është mirë të zbatohen janë ato kushte për të cilat të gjithë dijetarët janë pajtuar për moszbatimin e tyre.
- Kemi edhe kushte për të cilat dijetarët kanë dhënë mendime të ndryshme se a duhet zbatuar apo nuk duhet zbatuar, por mendimi më i drejtë është se nuk duhet zbatuar.

8. Trashëgimtari nuk ka të drejtë testamenti.

Në fillim të islamit testamenti ka qenë obligativ për prindërit dhe familjarët. Këtë e tregon ajeti në Kur'anin fisnik:

“U është bërë juve obligim, kur ndonjërit prej jush i është afruar vdekja, nëse lë pasuri pas vete, le të testamentojë testamentin për prindërit dhe për të afërmit, por ashtu siç është drejtë...” (El-Bekare : 180)

Pastaj testamenti është specifikuar me ajetet e trashëgimisë, që do të thotë:

- Trashëgimia u takon trashëgimtarëve.
- Testamenti u takon jotrashëgimtarëve.

Rregulla e cila e ka bazën në hadithin e Muhamedit a.s. e ka kuptimin:

- Asnjëri nga ju të mos lë testament diçka për trashëgimtarin, sepse Zoti i Lartmadhëruar secilit trashëgimtar ia ka përcaktuar të drejtën dhe është e padrejtë të përfitohen dy të drejta për diçka në të njëjtën kohë, se i bëhet e padrejtë palës tjetër.

Nga kjo rezulton se:

- Nëse një person i lë testament trashëgimtarit, ai testament është i pavlefshëm (nuk zbatohet).
- Nëse një person i lë testament një trashëgimtarit dhe pajtohen trashëgimtarët tjerë, atëherë llogaritet si dhuratë prej trashëgimtarëve dhe jo si e drejtë testamentale.

Kjo bazohet në hadithin të cilin e transmeton Ibn Abasi r.a. se pejgamberi s.a.v.s ka thënë: **“Nuk i lejohet testament trashëgimtarit, pos nëse e lejojnë trashëgimtarët tjerë.”**

Përfundim:

Ky lloj testamenti nuk konsiderohet testament i ligjësuar si testament në kuptimin e fjalës, por konsiderohet dhuratë prej trashëgimtarëve tjerë.

EZ- ZEKAAAT LAA TEXHUUZ ALEL USUUL VELAA ALEL FURUUË

9. Zekati nuk lejohet për lozën e poshtme dhe lozën e epërme.

Zekati nuk lejohet për lozën e poshtme dhe lozën e epërme.

Çka nënkuptojmë me lozën e poshtme dhe lozën e epërme?

Loza e poshtme janë:

- Fëmijët (djem dhe vajza);
- Fëmijët e fëmijëve (fëmijët e djemve dhe fëmijët e vajzave), e kështu me radhë.

Loza e epërme janë:

- Prindërit (baba, nëna);
- Gjyshërit dhe gjyshet nga ana e babës;
- Gjyshërit dhe gjyshet nga ana e nënës, e kështu me radhë.

Sa i përket familjarëve tjerë si f.v.: vëllezërve, motrave, xhaxhallarëve, tezeve, dajallarëve, hallave (dhe fëmijëve të tyre), këtyre u takon Zekati.

Muhamedi a.s. ka thënë:

“Sadakaja (Zekati) për të varfrin është sadaka, por për farefisn ka rëndësi të dyfishtë: sadaka dhe lidhje farefisnore.”

Nga hadithi kuptojmë se zekati (sadakaja) për farefisn ka vlerë të dyfishtë:

- vlerë të sadakasë dhe
- vlerë të lidhjes farefisnore.

Lidhja farefisnore ndërlidh dhe forcon lidhjen me Allahun, ndërsa ndërprerja e lidhjes farefisnore ndërprende dhe dobëson lidhjen me Allahun.

Urtësia e këtij rregulli

Ligji Islam nuk e lejon zekatin për lozën e epërme dhe lozën e poshtme sepse zekatdhënësi e ka për obligim përkujdesjen për këto kategori dhe nëse ai u jep këtyre kategorive, atëherë ai ka realizuar përfitim personal sepse shpenzimi për këto kategori duhet të jetë nga pasuria e tij personale përpos zekatit, ndërsa zekati dhe përkujdesja nuk mund të jenë në të njëjtën kohë për një person.

Nuk lejohet që borxhdhënësi ta llogarit borxhin e tij zekat

Nuk lejohet që një borxhdhënësi i cili i ka dhënë borxh një njeriu që nuk ka mundësi ta lajë borxhin ta zbrersë si pjesë të zekatit.

MEN ESLEFE, FEL JESLIF FII KEJLIL MEALUUM VE VEZNIN MEALUUM ILAA EXHELIN MEALUUM

10. Kush krediton, le të kreditoj me sasi të caktuar në masë të caktuar dhe në afat të caktuar

Kjo rregull tregon për llojin e shitblerjes me paradhënie.

Shitblerja me paradhënie ligjërisht është e lejuar, edhe pse në përmbajtje ka një lloj paqartësie dhe mashtrimi.

Pse është e lejuar kur dihet se në vetvete ka një lloj mashtrimi të vogël?

Përgjigjja:

- Është e lejuar për të siguruar interesin shoqëror dhe individual.
- Është e lejuar për të lejuar tolerancën në tregti.
- Është e lejuar për të mos bllokuar bashkëveprimin në mes të njerëzve.

Shembull, ai i cili ka pasuri, ka nevojë të blejë frutat. Pronari i pemëve ka nevojë për të holla që t'i shpenzoj për veten dhe familjen.

Për këtë arsye kjo lloj shitblerjeje është e lejuar.

Krahaso më këtë edhe paradhëniet në produktet industriale.

Argumentet e këtij rregulli

Argument nga Kur'ani

Thënia e Zotit të Lartmadhëruar:

“O ju të cilët keni besuar, kur të i jepni borxh njëri-tjetrit deri në një afat të caktuar, shkruajeni (regjistrojeni).” (El- Bekare : 282)

Argument nga Suneti

“Transmetohet nga Abasi se kur Muhamedi a.s. shkoi në Medine, medinasit i tregtonin hurmat për një vit dhe për dy vite, atëherë Muhamedi a.s. u tha:

Kush tregon me paradhënie për hurma (le të tregtoj) në sasi të caktuar, në masë të caktuar dhe me afat të caktuar.”

Argument nga ixhmai

Për këtë është themeluar edhe aprovimi i ixhmait. Siç këtë e tregon Kurtubiu dhe të tjerët pos tij prej fukahave, tefsirologëve dhe hadithologëve.

ET- TABIU TABIUN

11. Mbështetësi në Çështje është edhe vetë çështja

Shpjegimi i rregullës

Mbështetësi i një Çështjeje e pason Çështjen edhe në ligjësim, sepse e mbështetura në një Çështje nuk mund të jetë e pavarur në ligjësim.

Shembull

Blerja e kafshës shtëpiake; me kafshën bën pjesë edhe foshnja (viçi) brenda saj. Në bazë të kësaj, edhe prerja e kafshës konsiderohet edhe prerja e kafshës së saj.

“Transmeton Ebu Davudi nga Ebi Seid el Hudriji se ka thënë: E kemi pyetur pejgamberin a.s.

O i dërguari i Allahut, e therim devenë, ose e presim lopën, ose delen, ndërsa e shohim foshnjën në barkun e saj, a ta hedhim apo të ushqehemi me të.

Pejgamberi a.s. ka thënë:

Hani nëse dëshironi sepse prerja e saj është në bazë të prerjes së nënës së saj.”

Nëse foshnja del e gjallë, atëherë prehet me prerje sheriatike, sepse pasi shkëputet prej barkut të saj e gjallë nuk konsiderohet mbështetëse e nënës së saj.

Nëse ngordh pasi që del e gjallë, dhe nuk ka mundësi të pritët, kanë dhënë mendime të ndryshme.

Nga kjo rregull rezultojnë edhe shumë Çështje tjera, si p.sh.:

- Çështjet shtesë (mbështetëse) të sendit të blerë para dorëzimit të mallit, i takojnë blerësit.

- Çështjet shtesë (mbështetëse) të sendit të uzurpuar i takojnë të uzurpuarit, jo uzurpatorit.

EN- NAAXHISHU AAKILU RRIKAA

12. Mashtruesi është ngrënës i kamatës.

Fjala **nexhsh** e ka kuptimin e *lavdërimit të pamerituar, të paarsyeshëm dhe të panevojshëm*.

Kuptimi i rregullit

Lavdërimi i artikullit, për ta shtrenjtuar çmimin për t'i mashtruar (tërhequr) njerëzit për ta blerë artikullin me çmim sa më të lartë. Ky lloj mashtrimi është i ndaluar.

Nexhsh është lloj kamate nga shkaku se shitësi e mashtron blerësin për të përfituar në çmim sa më të lartë. Kështu bën padrejtësi duke e shfrytëzuar paditurinë e blerësit për atë artikull. Kjo i ngjanë kamatës sepse mu sikur kamatëdhënësi e shfrytëzon rastin për të përfituar çka nuk i takon.

Ky kriter në aspekt të përgjithshëm ndalon çdo mashtrim si f.v.: monopolizimin e mallrave, kurdisjen e çmimeve, etj., sepse këto veprimtari i përngjajnë kamatës.

Kusht i vlefshmërisë së shitblerjes është që edhe shitësi edhe blerësi të jenë besnik, të mos jenë mashtrues, të jenë të sinqertë, të mos jenë gënjeshtarë.

Kjo lloj shitblerje edhe nëse konsiderohet e plotfuqishme nga ana formale, në realitet me shitblerje të tillë bëhet mëkat.

Taberaniu e ka regjistruar hadithin merfuë se Muhamedi a.s. ka thënë: **“Mashtruesi llogaritet kamatngrërës dhe mashtrues i mallkuar.”**

MAA KAANE EKThERU FIËLEN KAANE EKThERU FADLEN

13. Angazhimi dhe veprimi i shumtë ka vlerë më të madhe.

Bazë e këtij parimi është hadithi:

“Shpërblimi yt është në bazë të mundësisë dhe angazhimit tënd.”

Shembuj

- Agjërimi në ditët e nxehta ka vlerë më të madhe se agjërimi në kohë të ftohta.

- Agjërimi në ditët e gjata ka vlerë më të madhe se agjërimi në kohë të ftohta.

- Agjërimi i plakut në ditë të nxehtë dhe të gjatë ka vlerë më të madhe se agjërimi i të riut në të njëjtën ditë.

- Ai i cili me singeritet udhëton dhe thërret në rrugë të Allahut ka shpërblim më të madh se ai cili fton në rrugë të Allahut në shtëpinë e tij, në xhaminë e tij ose në vendin e tij.

Përrjashtim nga ky rregull:

Gjatë udhëtimit, shkurtimi i namazit është më i vlefshëm se falja e plotë.

EL KURUATI TEKUUNU INDE TEZAAHUM

14. Shorti hidhet kur të drejtat janë të barabarta

Në etimologji do të thotë: *pjesë, hise*.

Në terminologji do të thotë: *veprim (proces) i cili përcakton pjesën apo hisen e njeriut*.

Dijetarët janë unifikuar në ligjësimin e shortit.

Argumenti i shortit buron nga Kur'ani dhe suneti.

Argument nga Kur'ani

Tregimi me rastin e Zekerijait a.s. dhe popullit të tij:

“Ti nuk ishe ndër ta kur i hidhnin shortet se kush prej tyre do të bëhej kujdestar i Mejremes, nuk ishe pranë tyre as kur ata ziheshin mes vete.” (Ali imran : 44.)

Tregimi i Junusit kur ishte në anije dhe i ra shorti që të hidhet në det.

“Edhe Junusi ishte një nga të dërguarit Tanë. Kur iku te anija që ishte e mbushur plotë (udhëtarë). E ai mori pjesë në short, po humbi (i ra shorti atij).” (Es-Saffat : 139-141)

Argument nga suneti

Transmeton Ebu Hurejrete r.a. se një popull i cili kishte mospajtueshmëri në mes vete rreth një përbetimi (se cili prej tyre duhej të përbitohej), paraqiten te pejgamberi s.a.v.s., pastaj ata u urdhëruan që të hedhin short në mes tyre se cili prej tyre të përbitohej.

(Hadithin e ka regjistruar Buhariu)

Urtësia e Shortit

Urtësia e hedhjes së shortit qëndron në atë se i qetëson zemrat e atyre të cilat i kanë të drejtat e njëjta në atë çështje dhe mënjanimin e akuzimit të njëri-tjetrit se ndonjëri ka pasur më shumë të drejt se tjetri.

Llojet e shortit

Llojet e shortit janë:

- Shorti i lejuar;
- Shorti Mendub;
- Shorti Vaxhib;
- Shorti Haram;
- Shorti Mekruh.

- **Shorti i lejuar:** është në Çështjet e lejuara, e cila nuk ndikon në armiqësi, ose nuk ndikon në dëmtimin e palëve.

- **Shorti mendub:** është në rastet kur zemrat qetësohen duke mos e akuzuar njëri-tjetrin.

- **Shorti vaxhib:** në raste ku duhet mënjantuan armiqësinë e palëve.

- **Shorti mekruh:** në Çështjet e papëlqyeshme.

- **Shorti haram:** në Çështjet e ndaluara.

Shorti si proces mund të zhvillohet në shumë Çështje. Në Çështjet kur palët kanë të drejta të barabarta dhe përcaktimi i njëres të drejtë ndaj të drejtës së njëjtë në palën tjetër.

Shembull:

- Kur bashkëpronarët kanë pjesë të barabarta në një shtëpi, parcelë të ngjashme dhe secili e dëshiron një pjesë të caktuar për shkak se secilit i përshtatet ajo pjesë, atëherë veprohet procesi i shortit, në mënyrë që të ndërpriten mosmarrëveshjet.

Përmbajtja:

KAPITULLI I PARË	7
1. Çështjet gjykohen sipas qëllimeve.....	8
2. Qëllimi dhe nijeti llogariten në veprime dhe deklarime ashtu siç llogariten në shpërblime dhe adhurime.....	13
3. Në akte llogaritet qëllimi dhe kuptimi, ndërsa nuk llogaritet fjala dhe konstrukti i fjalës.....	15
 KAPITULLI I DYTË	19
1. E dyshimta nuk e zhvlerëson të sigurtën.....	20
2. Në esencë çdo gjë mbetet ashtu siç ka qenë.....	23
3. Esenciale të mbetet çështja ashtu siç ka qenë, deri sa të mos vërtetohet se është ndryshuar.	25
4. Ligji i gravitimit dhe largimi i dyshimit dhe gjykimit se çdo gjë mbetet siç ka qenë.	26
5. Te çështjet, esenciale është lejimi.	27
6. Esenciale në të drejta është mosobligueshmëria.	29
7. Në esencë ndodhia e re i përshkruhet kohës më të afërt.	30
8. Të sigurtat nuk kundërshtohen në mes vete	31
 KAPITULLI I TRETË	33
1. Dëmi nuk largohet me dëmtim.....	34
2. Dëmi më i madh largohet me dëmin më të vogël	35
3. Kur të paraqiten dy të këqija, prej dy të këqijave veprohet me të keqën më të lehtë.....	36
4. Nuk ka obligueshmëri në pamundësi dhe nuk ka ndalesë në rast domosdoshmërie.	38
5. Vështirësia nuk lejon të drejtën e tjetrit.	41
6. Dëmi individual duhet të përballohet për t'u mënjeluar dëmi i përgjithshëm.....	42

7. Dëmi eliminohet në bazë të mundësive	43
KAPITULLI I KATËRT.....	44
1. Zakoni është ligj.....	47
2. E përdorura në traditë është sikurse e kushtëzuara me kusht.....	50
3. Ajo që është e njohur në mesin e tregtarëve është si të ishte kusht në mesin e tyre.	51
4. Ajo që është caktuar në bazë të zakonit është sikur të ishte e caktuar me tekst.	52
5. Nuk mohohet ndryshimi i dispozitave në bazë të ndryshimit të kohëve.	53
KAPITULLI I PESTË.....	55
1. Pastërtia është gjysma e besimit.....	56
2. Uji është i pastër përderisa nuk e humb ngjyrën, shijen apo erën..	59
3. Kur të prezanton uji, prishet Tejemumi.	60
4. Besimtari mbetet i pastër.....	61
KAPITULLI I GJASHTË	62
1. Çdo risi është bid'at.	63
2. Argumentimi për akuzuesin (pretenduesin), përbetimi për të akuzuarin (mohuesin).....	67
3. Padituria, harresa dhe pavetëdija edhe pse nuk konsiderohen mëkat, gjykim merret për ta.	69
4. Pajtimi është i lejuar, pos pajtimit i cili e lejon ndaluarën apo e ndalon të lejuarën.	71
5. Përfitimi shkon proporcionalisht me dëmtimin.	75
6. Kush përshpejton një të drejtë ligjore (me pa të drejtë) dënohet me ndalim të asaj të drejte.	76
7. Çdo kusht i cili nuk është në librin e Allahut është i pavlefshëm..	78

8. Trashëgimtari nuk ka të drejtë testamenti.	79
9. Zekati nuk lejohet për lozën e poshtme dhe lozën e epërme.	80
10. Kush krediton, le të kreditoj me sasi të caktuar në masë të caktuar dhe në afat të caktuar	82
11. Mbështetësi në Çështje është edhe vetë çështja	84
12. Mashtruesi është ngrënës i kamatës.	85
13. Angazhimi dhe veprimi i shumtë ka vlerë më të madhe.....	86
14. Shorti hidhet kur të drejtat janë të barabarta	87

